forum 2015

Projekt i Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur

SEKTORI BANKAR: NDIHMESË APO BARRIERË

RIINVEST INSTITUTI PËR HULUMTIME ZHVILLIMORE
INSTITUTE FOR DEVELOPMENT RESEARCH

Këtë analizë e ka punuar
INSTITUTI RIINVEST

forum 2015

SEKTORI BANKAR:
NDIHMESË APO BARRIERË

Këte analizë e ka punuar
INSTITUTI RIINVEST

Ekipi hulumtues:

Fadil Aliu, MSc – Menaxher i Projektit
Alban Hashani, MSc – Hulumtues i lartë
Lumir Abdixhiku, MSc – Hulumtues i lartë
Diellza Gashi, MSc – Hulumtuese
Ilire Mehmeti, MSc – Hulumtuese

Konsulent

Profesor Shkelqim Cani – Konsulent Ndërkombëtar
(Universiteti i Tiranës, Shqipëri)

Ky hulumtim është implementuar nga Instituti Riinvest dhe përkrahur nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS)

Publikuar nga: Forum 2015
Financuar nga: Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Tirazhi: 500

Përmbajtja

AKRONIMET

AKB	Aleanca Kosovare e Bizneseve
BiH	Bosnja dhe Hercegovina
AKK	Agjencia Kadastrale e Kosovës
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
BERZH	Banka Evropiane për Riindërtim dhe Zhvillim
BE	Bashkimi Evropian
EURIBOR	Norma Orfertuese e Euro InterBank
IJD	Investimet e Jashtme Direkte
BPV	Bruto Produkti Vendor
RZN	Raporti i Zhvillimit Njerëzort
IHH	Indeksi Herfindahl-Hirschman
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
KKK	Komisioni Kosovar i Konkurrencës
OEK	Oda Ekonomike e Kosovës
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KFOS	Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Trusti	Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës
LIBOR	Norma Orfertuese e London InterBank
IMF	Institucionet Mikrofinanciare
KJP	Kreditë Joperformuese
AKP	Agjencia Kosovare e Privatizimit
p.p.	pikët e përqindjes
RIINVEST	Instituti Riinvest Për Hulumtime Zhvillmore
ROA	Kthimi në Asete
ROAA	Kthimi Mesatar në Asete
ROAE	Kthimi Mesatar në Kapital
ROE	Kthimi në Kapital
NVM	Ndërrmarjet e Vogla dhe të Mesme
EJL	Evropa Jug-Lindore
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
KB	Kombet e Bashkuara
UNDP	Programi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara
BB	Banka Botërore

Përmbledhje

Sistemi bankar në Kosovë ka arritur që të fitojë besimin e individëve dhe bizneseve thellësisht duke pasur parasysh zhvillimin e tij nga zeroja. Sot, shumë raporte ndërkombëtare e vlerësojnë sektorin bankar si të fuqishëm dhe të qëndrueshëm përballë krizave financiare në regjion dhe më gjerë. Sidoqoftë, megjithëse i qëndrueshëm dhe i fuqishëm, sistemi bankar mbetet ndër barrierat kryesore në mjedisin biznesor kosovar. Normat e larta të interesit dhe qasja e ulët në financa për biznese janë duke e penguar në mënyrë serioze zhvillimin e sektorin privat dhe rrjedhimisht zhvillimin ekonomik të Kosovës. Pas rreth dymbëdhjetë viteve të themelimit, duke marrë parasysh perceptimet e akterëve, është e vështirë të thuhet se sektori bankar ka luajtur rolin e tij të lehtësimit në rindërtimin ekonomik; përkundrazi sot ky sektor paraqitet si një pengesë serioze për çfarëdo iniciativë potenciale nga sektori privat.

Ky raport ofron një analizë të gjendjes aktuale të sistemit bankar, dhe ndikimin potencial që sektori bankar ka mbi zhvillimin ekonomik. Paraprakisht, shumë raporte studimore kanë treguar se për arsye të koncentrimit të tregut në sektorin bankar në Kosovë, normat e interesit për kredi duket të jenë më të lartat në rajon. Anketat me Ndërrmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM) në të kaluarën gjithashtu kanë treguar që normat e interesit të kredive janë shumë të larta, dhe një nga pengesat kryesore të zhvillimit të tyre. Ekspertët e sektorit bankar gjithashtu tregojnë se normat e interesit janë më të lartat në rajon dhe potencialisht të pa-përballueshme për NVM-të në Kosovë. Në këtë drejtim, Instituti Riinvest me përkrahjen e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS) panë nevojën për një studim hulumtues si një përpjekje primare në realizimin e një analize gjithëpërfshirëse për përcaktuesit e normave të interesit të kredive në Kosovë, si dhe analizë të problemeve potenciale të lidhura me vështirësitë e qasjes në burime financiare të ofruara nga bankat komerciale. Institucionet Mikrofinanciare (IMF) përbëjnë një pjesë shumë të vogël të sektorit financiar, dhe për këtë arsye nuk janë temë e këtij studimi.

Metodat e analizës përfshijnë hulumtim nga të dhënat sekondare, një anketë gjithëpërfshirëse e Industrisë Bankare përfshirë aspektet e ndryshme të produkteve dhe shërbimeve të tyre me fokus të veçantë në normat e interesit, si dhe një anketë me 600 NVM, për marrjen e perceptimeve të komunitetit biznesor lidhur me normat e interesit të kredive të ofruara nga industria bankare. Gjithashtu janë implementuar intervista të drejtpërdrejta me përfaqësues të bankave, NVM-ve, si dhe akterë të tjerë si Banka Qendrore e Kosovës (BQK), shoqata biznesore, Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK), dhe agjencitë rregullatore. Janë bërë përpjekje të ndryshme që të intervistohen edhe Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë dhe Këshilli Gjyqësorë, por ata kanë refuzuar kërkesat tona. Një pyetësor gjysmë i strukturar me pyetje specifike si dhe të hapura është përfunduar për çdo intervistë.

Rezultatet tregojnë që sistemi bankar në Kosovë karakterizohet me një prezencë të madhe të kapitalit të huaj, ku 89.2% e aseteve totale janë të menaxhuara nga bankat e huaja, dhe kapital i huaj dominon në 6 prej 8 bankave që operojnë në Kosovë. Prezenca e tyre kontribuon në modernizimin e sistemit financiar në Kosovë me prurjen e praktikave më të avancuara në financa dhe menaxhimin e operacioneve bankare. Rezultatet gjithashtu tregojnë që bankat në Kosovë vazhdimisht kanë zgjeruar aktivitetet e tyre, kanë rritur depozitat, asetet dhe gjithashtu kreditë për bizneset dhe

amvisëritë nga viti në vit. Sa i përket strukturës afatizuese të depozitave, në dhjetor të vitit 2011, depozitat kohore me më pak se dy vite afatizim përfaqësonin 82% të depozitave, ndërkaq, kreditë me mbi dy vite gjatësi përfaqësonin 72.4% të numrit total të kredive, pa ndryshuar shumë nga periudha paraprake. Kjo reflekton një mospërputhshmëri të lartë ndërmjet afatit të kredive dhe afatit të depozitave, dhe sipas bankave, një nga arsyet e normave të larta të interesit. Praktikat e përgjithshme nëpër botë tregojnë që depozitat e amvisërive janë gati tërësisht të ripërtërira afër fundit të afatizimit të tyre, argument ky që vë në dyshim arsyetimin e bankave komerciale për norma të larta të interesit.

Sa i përket pozitës së likuiditetit (raportin ndërmjet kredive dhe depozitave) në dhjetor të vitit 2011, ky raport qëndronte në 80.8%, duke tejkaluar në masë shumë të vogël kërkesat e rekomanduara nga BQK[1], dhe si rezultat duke e ulur pozitën e likuiditetit. Duke pasur parasysh këtë, të gjitha kreditë mbi 10,000 euro, sipas kërkesave të bankave komerciale janë të garantuara me kolateral, dhe veçanërisht kreditë e NVM-ve shpesh garantohen nga patundshmëri të kompanisë (depo apo zyre), apo nga shtëpitë e pronarëve. Rrjedhimisht, raporti i mbulimit të kredive me kolateral në Kosovë në vitin 2011 qëndroi në 236.1%, që liston këtë raport si më të lartin në rajon (raporti mesatar në rajon ishte 126.6%)[2] . Sa i përket kolateralit, kreditë e NVM-ve në Kosovë janë kreditë më të mbuluara në rajon, që potencialisht i bën ato edhe me risk më të ulët. Kjo gjithashtu tregohet edhe nga niveli i kredive joperformuese (KJP), i cili qëndron në 6% sipas të dhënave të shatorit 2011, duke e ranguar Kosovën më poshtë në regjion krahasuar me mesataren e rajonit prej 16%, që tregon se mesatarisht në Kosovë portfolio e kredive është e kualitetit më të lartë se e shteteve tjera në rajon.

Lidhur me konkurrencën e bankave, hulumtimi ynë tregon që përkundër një trendi në rënie, sistemi bankar vazhdon të jetë shumë i koncentruar në tri bankat më të mëdha, të cilat ndajnë pjesën më të madhe të tregut rreth 74% të aseteve, 74% të depozitave dhe 71.7% të kredive nga fundi i dhjetorit të vitit 2011. Koncentrimi i lartë në sistemin bankar tregohet edhe nga Indeksi Herfindahl-Hirschman (IHH), ku në dhjetor 2011, asetet totale karakterizoheshin me një nivel koncentrimi prej 2,157 pikë, gjë që tregon që koncentrimi i tregut në sistemin bankar vijon të jetë i lartë. Indikator tjetër i matjes së nivelit të konkurrencës në sektorin bankar, është diferenca e normave të interesit të kredive dhe normave të interesit të depozitave, që në Kosovë shënohet me 10.8 pikë përqindje (më e larta në rajon), që tregon së përkundër numrit të shtuar të bankave në vitet e fundit, ndikimi i tyre në fuqizimin e konkurrencës në sektorin bankar në Kosovë ka qenë jo-signifikant. Diferenca ndërmjet normave të interesit të kredive dhe depozitave në sistemin bankar konsiderohet si një indikator i efiçiencës së ndërmjetësimit financiar. Diferenca e madhe ndërmjet normave të interesit të kredive dhe depozitave, konsiderohet të jetë një pengesë e lartë e ndërmjetësimit financiar, sepse dekurajon kursimtarët potencial për arsye të kthimit të ulët nga depozitat, ndërsa rrit koston e financimit për huamarrësit (individë apo biznese kryesisht), kështu që redukton mundësitë për investime dhe rritje ekonomike. Kjo është veçanarisht shqetësuese për ekonomitë në tranzicion, ku mundësitë për alternativa të financimit përmes tregut të kapitalit janë minimale apo edhe gati jo-ekzistente si në rastin e Kosovës, duke lënë Kosovën totalisht nën "mëshirën" e sistemit bankar që është dominues në sistemin financiar në Kosovë.

1 Rregullatori nga BQK ka rekomanduar që deri në 80% e depozitave të ipen si kredi.

2 Raporti i Stabilitetit Financiar (faqe 96), Dhejtor 2010

Në këtë aspekt, statistikat e BQK-së tregojnë që kreditë janë rritur ndër vite, ku në vitin 2011 kredit kanë shënuar rritje vjetore prej 16.6%, ndërkaq normat e interesit për kredi individuale në përgjithësi ishin 14.2%, përderisa norma e interesit të kredive për NVM, veçanarisht për nevoja të investimit kapital afatgjatë, qëndron në 16.65%, duke shënuar normat e interesit për kredi më të larta në rajon. Për shkak të normës së lartë të interesit për kredi, krahasuar me rajonin, Kosova shënon raportin më të ulët ndërmjet BPV-së dhe kredive për sektorin e NVM-ve 28.3%, që pasqyron ndërmjetësim shumë të ulët të kredive dhe çasje të dobët tek NVM-të.

Nga ana tjetër, raporti i profitabilitetit dhe treguesit tjerë në Kosovë janë ndër më të mirët në rajon. Kthimi në kapital (ROE) në Kosovë ka arritur në 14.5% në dhjetor të vitit 2011, që është lartë mbi mesataren e rajonit (4%), përderisa kthimi në asete (ROA) prej 1.4% gjithashtu ishte më i lartë se mesatarja rajonale prej 0.3%, duke tejkaluar çdo shtet në rajon. Duke pasur parasysh faktin që treguesit e performancës së sistemit bankar janë ndër më të lartit në rajon, rezultatet e anketës me NVM, shoqatat biznesore, Komisionin Kosovar të Konkurrencës, dhe akterë tjerë, vërtetojnë perceptimin e tyre që kushtet e kredive në vend janë shumë të vështira dhe të pa përshtatshme për zgjerim biznesor; ndërsa tregu i kredive konsiderohet të jetë përbërësi kryesor në Kosovë për të arritur rritje të qëndrueshme ekonomike dhe themeli i adresimit të problemeve të rënda socio-ekonomike – papunësinë dhe varfërinë. Përkundër treguesve të lartë të profitit të sistemit bankar në Kosovë, BQK-ja nuk ka pasur asnjë aplikim për hapjen e ndonjë banke të re në tri vitet e fundit që mund të shihet si çështje serioze, dhe sipas BQK-së, kjo mund të jetë edhe si shkak i thellimit të krizës globale financiare nga vitit 2008, si dhe krizës së borxhit publik aktual në Eurozonë, gjë që ka ndikuar një numër të konsiderueshëm të bankave në Bashkimit Evropian, kështu që ka limituar zgjerimin e tyre të mëtutjeshëm në tregje të reja.

Duke iu referuar intervistave me akterë të ndryshëm, kyesisht BQK-së dhe qëndrimeve të bankave komerciale, treguesit e performancës së sistemit bankar në Kosovë e rradhisin atë si më të lartin në rajon, duke e bërë (nga ky këndvështrim) sistemin bankar në Kosovë, si më të sigurtin, më të shëndetshmin, dhe më stabilin në rajon. BQK dhe bankat komerciale, në kundërshtim me vlerësimet e NVM-ve, nuk i konsiderojnë normat e niteresit të kredive të larta, në fakt ata deklarojnë që normat e interesit janë në një trend në rënie. Ata deklarojnë që arsyeja që Kosova ka normat më të larta të interesit në rajon, qëndron në faktin se shtetet fqinje ballafaqohen me risk më të ulët të ambientit biznesor, dhe sa i përket secilit faktor të lartpërmendur në procesin e vlerësimit të kredive, me përjashtim të KJP-së, ata qëndrojnë shumë më mirë se Kosova, dhe rrjedhimisht rezultojnë në norma më të ulëta të interesit për kredi se në Kosovë. Për më tepër, sistemi bankar në Kosovë është shumë i ndjeshëm nga çështjet ligjore dhe zbatimi tyre si dhe është shumë i mbështetur nga efikasiteti i sistemit të drejtësisë në Kosovë, i cili vuan nga një shkallë e lartë e jo-efikasitetit, procedurave të shtyera (deri në shumë vite) për zgjidhjen e rasteve në gjykata për sektorin bankar, si dhe vonesa të tej-zgjatura në ekzekutimin e kolateralit.

Pjesë e këtij studimi është edhe anketa e NVM-ve me 600 kompani kosovare, rezultatet e së cilës tregojnë që kosto e financimit dhe çasja në financa janë ndër pengesat kryesore e të bërit biznes në Kosovë. Këta dy indikator theksojnë vështirësitë me të cilat ballafaqohen NVM-të përballë rritjes së kapitalit për zhvillimin e tyre, duke shtyrë ato të marrin kredi biznesore me normë të larë të interesit, kështu që duke reduktuar

potencialet e zhvillimit të tyre, apo në rastin më të keq, mos implementimi i ndonjë projekti investiv për shkak të normave të larta të interesit. Anketa gjithashtu tregon që shumica e bizneseve kanë theksuar "çasjen në dhe kostot e financimit" si pengesat kryesore për zgjerimin e tyre të mundshëm, duke vijuar me pasigurinë në ambientin e përgjithshëm biznesor që i rrethon këto firma. Anketa gjithashtu ka gjetur se 95% e NVM-ve nuk kanë aplikuar për kredi, për faktin që 70% e firmave mendojnë që kushtet e financimit janë të pafavorshme apo shumë të pavaforshme, duke bërë financimin e projekteve investive të NVM-ve praktikisht të pamundur.

Rekomandimet

Rekomandimet janë të sugjeruara për trajtimin e shumë prej pengesave të sipër përmendura. Ne rekomandojmë që:

- Qeveria duhet të fuqizojë rritjen ekonomike në nivel makroekonomik duke bërë reforma në ambientin biznesor përmes uljes së nivelit të informalitetit në ekonomi, luftuar konkurrencën e pandershme, tatimimin e tepruar, dhe rregulloret qeveritare të papërshtatshme. Reformat duhet që kryesisht të targetojnë promovimin e konkurrencës dhe zhvillimin e sektorit privat si mjet i rritjes ekonomike dhe kështu të trajtojnë stagnimin aktual të bizneseve. Përmirësimi i ambientit biznesor do të rezultojë në uljen e riskut të kredive, si një nga faktorët kryesorë të normave të interesit në Kosovë.

- Reformat institucionale siç janë përmirësimi i sundimit të ligjit, luftimi i korrupsionit, luftimi i ekonomisë informale, evazionit fiskal dhe inkurajimi i transaksioneve alternative (jo me kesh) do të krijonte kushte më të favorshme për bizneset eksistente dhe në të njejtën kohë tërheqte investime të jashtme në tregjet financiare në Kosovë. Për të parën, stimujt për formalizim do të përmirësonin raportimin financiar; ndërkaq për të dytën konkurrenca në tregun financiar do të ofronte mundësi të mëtejshme për uljen e normës aktuale të interesit.

- Zgjidhja e problemeve të sistemit kadastral, si dhe rritja e efiçiencës së sistemit gjyqësor do të rezultonte në ekzekutim më të lehtë të kolateralit të premtuar dhe pengut. Efiçienca akutale - shumë e pakënaqur, mungesa e një mekanizmi efikas dhe efiçient për zgjidhjen e shpejt të rasteve gjyqësore vështirëson mundësinë për uljen e normës aktuale të interesit. Krijimi i gjykatave speciale ekonomike përmes së cilave rastet biznesore do të ndaheshin nga rastet e përgjithshme do të kontribuonte në ulje të ndjeshme të ngarkesave aktuale. Kjo do të eliminonte një nga pengesat kryesore të jo-efikasitetit gjyqësor, të cilit i referohet bankat dhe bizneset në çdo kohë.

- Shtimi i mëtejshëm i konkurrencës në sistemin financiar mund të jetë zgjidhja e problemit. Qeveria duhet të vendosë politika favorizuese për investime (në mënyrë që të tërheqë investime të jashtme direkte të mundshme në sektorin bankar), përmes marketingut agresiv të kushteve investive në sistemin bankar të Kosovës dhe sektorët e tjerë.

- Qeveria duhet të ndërmarrë masa për përmirësimin e sistemit ligjor dhe instrumentet e tij për mbrojtjen e sigurimin e kolateralit kreditor, gjë që do të ulte riskun e lidhur me kolateralin e kredive sa i përket ekzekutimit të kolateralit.

- Në mënyrë që të shmangë krizat potenciale nga sektori financiar dhe ekonomia në përgjithësi, Qeveria duhet të fillojë procesin e përmbushjes së kërkesave kualitative në kushtet e paraqitura nga FMN-ja, Banka Botërore dhe BE-ja lidhur me shpenzimet qeveritare, dhe krijimin e një sigurie që do të ofrohet nga këto organizata në rast të ndonjë krize.

- Është e nevojshme, një fushatë nga Qeveria apo Banka Qendrore për të lëkundur/inkurajuar bankat të lëvizin nga satus quo-ja e tyre lidhur me normat e interesit të kredive. Kjo nuk nënkupton intervenim në çështjet e brendshme të bankave komerciale, po një mirëkuptim i ndërsjellë për kërkesën dhe definimin e agjendës me detyrat që lidhen me qeverinë, bankat, BQK-në, shoqatën e bankave, shoqatat biznesore, donatorët dhe institucionet ndërkombëtare, në mënyrë që të përmirësohet oferta e kredive për sektorin privat përmes rritjes së konkurrencës ndër-bankare.

- Qeveria duhet të tentojë të inkurajojë më shumë konkurrencën në sektorin financiar dhe të ndërmarrë veprime për përmirësimin e ofertës por kredi për sektorin privat, e veçanërisht përmes lëshimit letrave me vlerë (obligacioneve qeveritare). Interesi i përbashkët i të gjithë akterëve është rritja më e lartë ekonomike dhe masat parandaluese që do të siguronin sektorët ekonomik nga ndikimi i krizave aktuale Evropiane të borxhit. Në këtë aspekt ka shumë hapësirë për veprime nga të gjithë akterët.

- Qeveria duhet të krijojë programe për skema garantuese të fondeve për huadhënie tek NVM-të, duke u fokusuar në sektorët ekonomik me potencialin më të lartë për gjenerim të punësimit.

- BQK dhe shoqatat biznesore në Kosovë, në bashkëpunim me Qeverinë duhet të luajnë një rol më aktiv drejt zbutjes së pengesave me të cilat ballafaqohen bankat komerciale dhe NVM-të në përgjithësi.

- BQK inkurajohet që të ulë barrierat e jo-licencimit dhe të rrisë konkurrencën ndërbankare në Kosovë. Ndër të tjera, ulja e kostove të përdorimit të bankomatëve mund të jetë e rëndësishme në luftimin e barrierave jo-licencuese.

- BQK dhe bankat komerciale duhet të ulin nivelin e kolateralit si kërkesë për kredi në nivelet mesatare të rajonit, si dhe të përmirësohen ofertat e kredive për biznese me afat më të gjatë, në mënyrë që të mundësohet çasja më e lehtë në kredi për NVM.

- Në fund, Qeveria duhet ti kushtojë vëmendje përmirësimit të njohurive (rritjes së vetëdijes) financiare të ndërmarrësve dhe individëve përmes krijimit të qendrave këshilluese biznesore. Ofrimi i trajnimeve falas për zhvillimin e planeve të biznesit nga donatorët, OJQ-të, universitetet, qeveria, shoqatat e bankave dhe bizneseve, do mund të rrisin kapacitetet e individëve dhe ndërmarrësve për përparësitë e shërbimeve të ofruara financiare, dhe njëkohësisht ata do të ishin në një pozitë më të mirë për shmangien e riskut financiar.

1. Hyrje

Ky raport hulumtues ka për qëllim që të bëjë një studim që fokusohet në sektorin bankar të Kosovës. Ky studim i heton determinuesit e normave të interesit për kreditë e Kosovës me qëllim të identifikimit të faktorëve më signifikant që kanë ndikuar në nivelin dhe ngurtësimin e tyre përgjatë 12 viteve të fundit. Për më shumë, në këtë studim bëhen krahasime ndërmjet shteteve në nivel regjional duke iu bërë një analizë të detajuar praktikave të tyre. Kjo lidhet me objektivat e këtij studimi dhe nga kjo analizë do të nxirren rekomandime për politikëbërësit në mënyrë që këta të ndërmarrin masa konkrete të cilat do të mund të ulnin normat e interesit në tregun e brendshëm të kredive.

Theks i veçantë në këtë hulutim i është dhënë studimit të plotë të Industrisë Bankare, duke i përfshirë aspektet e ndryshme të produkteve dhe shërbimeve, e posaçërisht normat e interesit. Po ashtu, është zhvilluar një anketë me NVM për të marrë përshtypjet e komunitetit biznesor sa i përket depozitave dhe normave të interesit për kredi të ofruara nga sektori bankar. Intervistat e detajuara sy me sy janë zhvilluar me përfaqësues të bankave (Menaxherat e Riskut), përfaqësuesit e NVM-ve, si dhe me palët tjera të interesit, siç janë, BQK-ja, asociacionet e Biznesit, Agjencia e Kadastrës së Kosovës, dhe agjencitë rregullatore. Një pyetësor gjysmë i strukturuar që përfshinte pyetje specifike dhe një numër të pyetjeve kualitative (përgjigjet e të cilave janë me tekst) janë kryer për secilën intervistë. Projekti është financuar nga Fondacioni për Shoqëri të Hapur (KFOS) dhe është implementuar nga Insituti për Hulumtime Zhvillimore Riinvest. Gjatë përgatitjes së këtij raporti hulumtues ekipi i projektit ka bërë hulumtime sekondare të raporteve të ndryshme mbi bankat dhe kompanitë e sigurimit siç janë raporti i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), raportet vjetore të bankave, dhe literatura që përfshinë këtë fushë.

Struktura e këtij raporti hulumtues është e organizuar siç vijon. Ky raport fillon duke e prezantuar përmbledhjen ekzekutive, i pasuar nga seksioni 1. që prezanton hyrjen në raport. Seksioni 2 i këtij raporti bën një përshkrim të gjithëmbarshëm të sistemit bankar të Kosovës, duke i përfshirë produktet dhe shërbimet e ndryshme të ofruara nga bankat. Seksioni 3 vazhdon me një analizë të situatës aktuale të sektorit bankar, duke e përfshirë edhe analizën e legjislacionit dhe kornizës rregullatore. Seksioni 4 i nxjerr të gjeturat e anketës (të zhvilluara me përfaqësuesit e bankave) të lidhura me gjendjen aktuale të normave të interesit të ofruara nga sistemi bankar, dhe perceptimet e komunitetit biznesor (NVM-ve) sa i përket normave të interesit, ndërsa seksioni 5 e bën një analizë krahasuese ndërshtetërore me fokus në konkurrencën ndërmjet bankave. Në fund, seksioni i fundit i prezanton konkluzionet dhe disa rekomandime të raportit.

Ne dëshirojmë ta falënderojmë KFOS-in për sponzorimin e këtij projekti dhe për mbështetjen e vazhdueshme përgjatë fazave të implementimit. Posaçërisht, e falënderojmë Shkelqim Canin për bashkëpunimin e shkëlqyer me ekipin e këtij projekti. Dëshirojmë të theksojmë që të gjeturat dhe opinionet e prezantuara në këtë raport përfaqësojnë vetëm pozicionin e Institutit Riinvest dhe jo domosdoshmërisht reflektojnë pozicione të pjesëmarrësve të tjerë të involvuar gjatë realizimit të këtij projekti.

2. Përmbledhje e sistemit bankar në Kosovë

Institucionet financiare në Kosovë janë të licencuara dhe të mbikëqyrura nga BQK. Sektori financiar i shtetit e mbulon industrinë bankare, industrinë e sigurimeve, fondet pensionale dhe institucionet tjera financiare të cilat janë kryesisht të kompozuara nga skemat e mikro-kredive. Sa i përket numrit të institucioneve financiare që operojnë në Kosovë, struktura e këtij sistemi ka mbetur e pa ndryshuar për shumë vite, përjashtim bëjnë tri institucione financiare që i janë shtuar tregut në vitin 2011 (Tabela 1). Numri i përgjithshëm i institucioneve në sektorin financiar, siç shihet ne Tabelën 1, ka arritur të jetë 70 në fund të nëntorit 2011, me numrin më të madh të përbërë nga "financial auxiliaries" (32) dhe institucionet mikrofinanciare (17), që të dyjat se bashku bëjnë 49, të fundit bëjnë pjesën më të vogël të totalit të aseteve në sektorin financiar (42.25 përqind).

Tabela 1. Numri i Institucioneve Financiare në Kosovë

Përshkrimi	Nëntor 2008	Nëntor 2009	Nëntor 2010	Nëntor 2011
Bankat Komerciale	8	8	8	8
Kompanitë e Sigurimit	12	11	11	11
Fondet Pensionale	2	2	2	2
Ndihmësit Financiar	29	28	29	32
Institucionet Mikrofinanciare	16	19	17	17

Burimi: BQK Raporti I stabilitietit financiar (2011)

Pavarësisht që këto industri janë profitabile dhe në vazhdimësi i kanë zgjeruar aktivitetet e tyre, fakt ky që ka ndikuar në nxitjen e institucioneve të reja financiare të hyjnë në treg, gjatë tri viteve të fundit, numri i bankave komerciale, i kompanive të sigurimit dhe fondeve të pensioneve ka mbetur i pandryshuar.

2.1 Bankat komerciale

Sektori bankar në Kosovë është zhvilluar me sukses dhe nga shumë (FMN 2012) konsiderohet si një storje e suksesit. Vlera e sektorit bankar të aseteve/detyrimeve në Kosovë në nëntor të vitit 2011 ishte 2.63 miliard euro, shumë kjo e cila është 11.9% më e lartë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar (shih Tabelën 2). Që nga fundi i vitit 2000, kur banka e parë e pasluftës është themeluar, vlera e përgjithshme e aseteve në sektorin bankar siç shihet në Tabelën 1 ka shënuar rritje përafërsisht 26 herë.

Tabela 2: Të dhënat bankare, në miliarda euro

Vitet	2000	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011
Asetet/Detyrimet	0.1	0.98	1.16	1.43	1.79	2.07	2.35	2.66
Depozitat	0.1	0.84	0.92	1.14	1.42	1.55	1.71	2.10
Kreditë	0.02	0.51	0.64	0.89	1.19	1.28	1.42	1.69

Burimi: Raportet Vjetore të BQK 2001-2010, dhe buletinet mujore te BQK

Sektori bankar në Kosovë karakterizohet me një prezencë të madhe të kapitalit të huaj, ku 89.2% e të gjitha aseteve menaxhohen nga bankat e huaja. Prezenca e institucioneve financiare të huaja në Kosovë ka kontribuar në modernizimin e sistemit financiar duke sjellë praktika të avancuara në financimin dhe menaxhimin e operiacioneve bankare. Në Kosovë, për momentin operojnë tetë banka, gjashtë prej tyre me të gjithë ose me shumicen e kapitalit të huaj.

Sektori bankar në Kosovë mbetet shumë i koncentruar. Në fund të dhjetorit të vitit 2011, tri bankat më të mëdha së bashku përbënin rreth 74% të aseteve në sektorin bankar, 74% të depozitave dhe 71.7% të kredive. Niveli i tregut të koncentruar bankar është më i ulët në krahasim me vitin 2008, kur depozitat dhe astetet e tri bankave mbulonin 90% të këtij tregu. Koncentrimi i lartë i tregut bankar vërtetohet dhe nga Indeksi Herfindahl-Hirschman (HHI) që shihet në Figurën 1. Në 2008, HHI për asete shënonte 2,887 pikë krahasuar me 2,896 pikë që ishte në periudhën e njejtë të vitit të kaluar, përderisa kreditë dhe depozitat shënuan 3014 respektivisht 3,016 pikë. Megjithatë, në nëntor të vitit 2011, bazuar në HHI për totalin e aseteve, sistemi bankar është karakterizuar me indeks të koncentrimit prej 2,157 pikëve, krahasuar me periudhën e njejtë të vitit të kaluar, ky ka pësuar rënie për 265.2 pikë. Indeksi i koncentrimit në sektorin bankar është vërejtur të ketë pësuar rënie të vazhdueshme nga viti 2008, nëse bazohemi edhe në HHI për depozita dhe kredi.

Figure 1. Koncentrimi i aktiviteteve bankare permes HHI



Burimi: BQK (2011)

Në mënyrë që shërbimet e sektorit bankar të jenë më afër klientëve, bankat komerciale kanë vazhduar të zgjerojnë infrastrukturën e tyre, ndonëse në dy vitet e fundit ky ritëm ka pësuar rënie. Kjo mund të ketë ndodhur për shkak së bankat që kanë qenë duke operuar në tregun e Kosovës kanë arritur të konsolidohen mirë me prezencën e tyre duke hapur degë bankare në gjithë territorin e Kosovës, dhe kështu ritmi i ngadalësuar i zgjerimit mund të jetë për shkak të masave të ndërmarra nga bankat për reduktimin e shpenzimeve në këtë drejtim.

3. Gjendja aktuale e Sektorit Bankar

Sektori bankar, i prezantuar ne tabelën 3 deri në fund të vitit 2008 ka pasur neto profit (34 milion euro) në vazhdimësi, pasuar nga një rënie e menjëhershme ne vitin 2009 ku profiti i bankave pësoi ulje ne 17.4 milion euro. Këtë ulje të profitit (24.1%) ia ngarkojnë qasjes burokratike të bankave dhe mos ekspozimit të tyre ndaj riskut (kryesisht për shkak të krizës së borxhit në Eurozonë), pasi që kërkesat e tyre për dhënien e kredive për NVM-të janë më rigoroze. Megjithatë, nga tabela 3 e shohim që neto profiti i bankave ka pësuar trend rritës ne vitin 2010 dhe ky trend ka vazhduar edhe në vitin 2011 ku ne fund të vitit 2011 shuma e neto profitit ne sektorin bankar ka qenë përafërsisht 37 milion euro me nja rritje vjetore prej 13%. Të ardhurat e sektorit bankar vijnë kryesisht nga interesi mbi kreditë ku të ardhurat nga interesi (që në vitin 2011 ishin 195 milion euro) krahasuar me të ardhurat totale të sektorit në fund të vitit 2011 (që ishin 240 milion euro) këto të ardhura nga interesi marrin pjese me 81.3% të të ardhurave totale, që është gati njësoj me pjesëmarrjen në fund të vitit 2010 (80.9%) dhe me atë të viteve të fundit.

Tabela 3: Të ardhurat e bankave dhe neto profiti

	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011
Te ardhurat totale të sektorit bankar	94.3	113.9	157.4	195.0	201.5	217.2	240
Te ardhurat nga interesi ne sektorin bankar	74.6	88.8	117.9	155.7	163.2	175.8	195
Neto profiti	13.5	20.1	33.5	34	27.4	32.8	37
Kthimi në Asete (ROA), në %	1.4	1.74	2.33	1.9	1.24	1.34	1.4
Kthimi Mesatar në Asete (ROAA), në %	1.52	1.88	2.62	2.1	1.39	1.44	1.46
Kthimi në Kapital (ROE), në %	18.24	19.46	21.94	18.65	13.33	14.23	14.50
Kthimi Mesatar në Kapital (ROAE), në %	18.87	22.67	26.17	20.30	14.13	15.04	15.23

Burimi: Raportet Vjetore të BQK

Kthimi në Asete (ROA)[3] – ROA tregon se si një kompani I kontrollon shpenzimet dhe si i shfrytëzon resurset e veta. Sa më I madh të jetë indikatori ROA është më mirë pasi që nënkupton që sektori bankar ka më shumë të ardhura nga më pak investime. Në vitin 2007 sektori bankar e ka pasur fitimin më të madh nga kthimi në asete me 2.33%, ndërsa në 2008 dhe 2009 shohim një rënie të menjëhershme të këtij indikatori. Gjatë viteve 2010 dhe 2011 ROA pësoi një rritje ku në fund të viti 2011 arriti 1.4%, shumë mbi mesataren në rajon (0.4%).

3 ROA paraqet shumën e fitimeve të gjeneruara nga secila njësi aseteve të përdorura. ROA është një ndër raportet të përdorura më së shumti pasiqë është e lidhur me mazhën e profitit dhe qarkullimin e aseteve. Kështu ROA paraqet raportin e kthumit edhe për kreditorët edhe për investitorët e kompanisë.

Kthimi Mesatar në Asete (ROAA)[4] – kthimi mesatar në asete (ROAA) llogaritet në fund të periudhës së caktuar (muaj, tremujor, vite etj.) dhe nuk përfaqëson të gjitha uljet/ngritjet por është një mesatare e një periudhe kohore. Prandaj, duke e analizuar tabelën 3 e shohim që ROAA është pak më e lartë se ROA në vazhdimësi çdo vit. Ky fakt na jep një pasqyrë më të saktë mbi përfitimin mesatar në sektorin bankar.

Kthimi në Kapital (ROE)[5] – nga Tabela 3 e shohim që ROE ka pësuar një ngritje në mënyrë të qëndrueshme deri në vitin 2007 duke arritur kështu në 21.94%. Ndërsa përsëri për shkak të krizës financiare globale si dhe prezencës së bankës së re ne treg ROE pësoi një ulje të konsiderueshme në vitin 2008 dhe 2009 duke arritur kështu në 13.33%. Prapë se prapë, edhe me krizën Europiane të borxheve dhe me konkurrencën e rritur në treg, në vitin 2010 dhe 2011 kthimi në kapital filloi të rritej, ku në fund të vitit 2011 ky indikator arriti në 14.5%, mbi tri herë me shumë se mesatarja në rajon (4%).

Kthimi Mesatar në Kapital (ROAE)[6] – në rastet kur kapitali I aksionarëve nuk ndryshon, ose pëson një ndryshim shumë të vogël, gjatë një viti fiskal, indikatorët ROE dhe ROAE duhet të jenë identikë ose së paku të ngjashëm. Megjithatë, analizimi i ROE dhe ROAE nga Tabela 3 tregojnë që ROAE paraqet një pasqyrë më të saktë të performancës në sektorin bankar me përjashtim të tri viteve të fundit ku shohim rezultate të ngjashme. Më herët ka pasur ndryshim të madh ndërmjet këtyre dy indikatorëve ndër vite.

3.1 Shërbimet Bankare

3.1.1 Depozitat dhe shpërndarja e tyre në sektorë

Në fund të vitit 2011 totali I depozitave në sistemin bankar në Kosovë arriti në 2.1 miliardë euro duke shënuar një rritje vjetore rreth 8.5 përqind. Trendi i rritjes më të ngadalshme e spikatur nga dhjetori 2009 ishte evident edhe gjatë kësaj periudhe duke pasur parasysh që norma e rritjes së depozitave në dhjetor 2011 ishte rreth 12.3%, e cila ishte më e ulët krahasuar me dhjetorin e vitit 2009. ngadalësimi I rritjes së depozitave erdhi më shumë si pasojë e zvogëlimit të depozitave të qeverisë në bankat komerciale si dhe implikimet e krizës financiare globale gjatë kësaj kohe. Këta dy faktorë ndikuan në një ngadalësim të madh në rritjen e depozitave. Që nga krijimi I sektorit bankar në Kosovë, çdo herë që ka pasur ngritje të depozitave, kjo është përcjellë nga një zvogëlim në numrin e kredive të lëshuara. Megjithatë, në tri vitet e fundit rritja e depozitave ka pësuar ulje të vazhdueshme ndërsa përqindja e kredive ka pasur një trend rritjeje te vazhdueshme nga viti në vit. Prandaj, në vitin 2010 për herë të pare rritja e kredive e ka tejkaluar rritjen e depozitave, dhe ky trend ka vazhduar edhe në vitin 2011 duke treguar një rritje të vogël në konkurrencën ndër-bankare dhe rritjen

4 ROAA – Është një indikator që përdoret për të bërë vlerësimin e profitabilitetit të aseteve të bankës. Më së shumti përdoret nga bankat dhe institucionet tjera financiare si mjet për të vlerësuar performancën e tyre.

5 ROE - ndryshe e njohur edhe si Kthimi në Investime (ROI), është matësi më i mirë I madhësisë së profitit të bankës I cili gjenerohet me nga paratë e investuara nga aksionarët.

6 ROAE – është një indikator që përdoret për matjen e Kthimit Mesatar në Kapital I cili mund të na japë një përshkrim më të saktë për profitabilitetin e kompanisë, sidomos në rastet kur vlera e kapitalit të aksionarëve ka ndryshuar shumë gjatë vitit të fundit fiskal.

e aktivitetit të bankave. Burimi kryesor I depozitave në sistemin bankar në Kosovë vazhdojnë të jenë depozitat e amvisërive të cilat në fund të vitit 2011 përbënin 1.49 miliardë euro (71% e totalit të depozitave). Mirëpo, kohëve të fundit është vërejtur një ngadalësim I rritjes së depozitave të amvisërive (14.7% rritje vjetore në dhjetor 2011 krahasuar me 25% në dhjetor 2010). Ngadalësimi i normës së rritjes së depozitave nuk është reflektuar në pjesëmarrjen e tyre në totalin e depozitave, duke marrë parasysh që depozitat e amvisërive përfaqësojnë 71% të totalit të depozitave në fund të vitit 2011 që është 3.8 pikë përqindje më e lartë se në dhjetor 2010 (Figura 2). Depozitat e ndërmarrjeve private arritën në 395.4 milion euro në dhjetor 2011 (400 milion euro në dhjetor 2010), e cila përbën një zvogëlim vjetor prej 1.2%. Nëse e krahasojmë rritjen e depozitave në kohën e fundit (rritja vjetore prej 18.5% në 2009, rritja vjetore prej 17.8% në 2010 dhe zvogëlimi në vit prej 1.2% në 2011) e shohim një ngadalësim të konsiderueshëm në rritjen e depozitave. Ndërsa depozitat nga ndërmarrjet publike si PTK, KEK, dhe Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës kanë mbetur njëjtë, duke arritur 127 milion euro në dhjetor 2011 (126.6 milion euro në dhjetor 2010). Është e rëndësishme të ceket që mbi 200 milion euro nga dividendët e PTK-së janë tërhequr prej bankave komerciale nga qeveria në vitin 2009. Në këtë rast, qeveria dhe BQK janë treguar shumë të kujdesshëm që kjo tërheqje masive nga bankat komerciale të mos krijojë shok në këtë sektor.

Figura 2. Struktura e depozitave sipas sektorëve, në përqindje



Burimi: Raportet vjetore të BQK dhe Buletini i BQK

Për sa i përket strukturës së maturimit të depozitave, në dhjetor 2011 dominonin depozitat me afat duke përfaqësuar 48.2% të totalit të depozitave, pasuar nga depozitat e transferueshme (depozita të cilat nuk janë subjekt i ndonjë lloj maturimi) me rreth 31% dhe depozitat e kursimeve me 15.1% të totalit të depozitave. Depozitat me maturim afatshkurtër, edhe pse kanë një trend rënës, vazhdojnë ta dominojnë strukturën e depozitave me afat. Në dhjetor 2011, depozitat me afat njëvjeçar të

maturimit përfaqësojnë 53.8% të depozitave me afat (duke rënë nga 75.7% në vitin 2010), pasuar nga 28.2% të totalit depozita me kohë maturimi mbi një vit deri në dy vjet (që përfaqësojnë një rritje prej 8.5% krahasuar me vitin 2010), dhe rreth 18% të depozitave me afat janë depozita me kohë të maturimit mbi dy vjet (e cila përfaqëson një rritje të lehtë prej 15.7% në 2010).

Duke marrë parasysh trendin të cilin depozitat me afat po e ndjekin, mund të vërejmë një tendencë ngritjeje të pjesëmarrjes së depozitave me afat më të gjatë maturimi. Kjo mund të jetë ndikuar edhe nga aprovimi i Ligjit mbi Sigurimin e Depozitave e cila ka ndikim te drejtpërdrejtë në rritjen e besueshmërisë në bankat komerciale nga depozitorët. Gjithashtu, norma e interesit e cila është më e lartë për depozitat me afat më të gjatë të maturimit mund të jenë një faktor i rëndësishëm që mund të ndikojë në rritjen e numrit të depozitave me afat më të gjatë të maturimit.

3.1.2. Kreditë dhe shpërndarja e tyre në sektorë

Aktivitetet në sektorin bankar janë zgjeruar sivjet dhe pjesëmarrja e aktivitetit të kredive në BPV-në e Kosovës është rritur në 38% krahasuar me vitin e kaluar (35% pjesëmarrje në BPV). Bazuar në të dhënat nga BQK, aktiviteti i kredive në bankat komerciale u karakterizua me një rritje të shpejtë. Pavarësisht nga kriza Europiane e borxhit, ku bankat europiane janë ballafaquar me mungesën e besueshmërisë nga klientët, profiti i bankave në vend tregon që bankat në Kosovë edhe më tutje kanë profit mbi mesataren e rajonit. Kjo sugjeron një përmirësim të percepsionit dhe një shkallë më të lartë të besueshmërisë të bankave komercialë për mjedisin ekonomik në Kosovë. Kështu, pas një periudhe ngadalësimi që erdhi si pasojë e krizës ekonomike globale në dy vitet e fundit, ne dhjetor 2011 vlera totale e kredive të lëshuara nga bankat arriti 1.7 miliardë euro duke shënuar kështu një rritje prej 16.4% krahasuar me dhjetorin e vitit 2010 (në vitin 2010 rritja vjetore e kredive ishte 13.2%). Këto të dhëna tregojnë ky aktivitet është në rritje në Kosovë.

Nga totali i kredive të lëshuara 67.4% kane shkuar për NVM-të, përqindje kjo e konsideruar e ulët krahasuar me mesataren e regjionit. Kjo e tregon varshmërinë e ekonomisë kosovare në tregti. Edhe pse tregu i kredive ka pasur një trend në rritje në këto tri vitet e fundit, kjo rritje është zhvendosur nga kompanitë në amvisëri, ku 30.1% e totalit të kredive kanë shkuar për amvisëritë krahasuar me rritjen vjetore prej 29.5% në vitin 2010. ndërsa kreditë për ndërmarrjet kanë pësuar një rritje ku në 2011 ato u rritën me 4.8% (Figura 3). Ky aktivitet i ulët i kredive për NVM-të në këto dy vitet e fundit në Figurën 3 mund të jetë e lidhur me krizën globale financiare (2008-2009) dhe me krizën Europiane të borxheve në 2010. këto dy fakte i kanë bërë bankat më të prirura që t'i financojnë amvisëritë më shumë së NVM-të.

Figura 3. Rritja vjetore e kredive sipas sektorëve, në përqindje



Burimi: Raportet vjetore të BQK dhe Buletini i BQK

Megjithatë, sapo kriza financiare filloi të qetësohet aktiviteti ekonomik global filloi të rimarrë ritmin e tij duke e shkaktuar një zvogëlim në normat e interesit të kredive për ndërmarrjet private, të cilat si rezultat kanë rritur kërkesën për kredi në këtë sektor. si rezultat i kësaj, në fund dhjetorit të vitit 2011 kreditë për ndërmarrjet private u rritën me 12.9% duke shënuar një rritje prej 8.1 pikë përqindje në krahasim me vitin 2010. ndërsa rritja e kredive për amvisëritë pësoi një zvogëlim prej vetëm 18% duke shënuar kështu në zvogëlim prej 11.5 pikë përqindje krahasuar me vitin 2010. ky zvogëlim i kredive për amvisëritë mund të jetë edhe rezultat i orientimit të sistemit bankar më shumë drejtë kreditimit të ndërmarrjeve gjatë kësaj periudhe që erdhi si rezultat i faktit që norma e interesit për kreditë e ndërmarrjeve është më e lartë duke i mundësuar bankës të gjenerojë më shumë profit.

Figura 4 tregon që struktura e kredive për ndërmarrjet në kushtet e aktivitetit ekonomik vazhdon të jetë e ngjashme me strukturën në periudhat e mëparshme. Kreditë në sektorin e shërbimeve vazhdojnë dominimin e strukturës së totalit të kredive për ndërmarrjet me një pjesëmarrje prej 71.6%. Në dhjetor 2011 sektori i tregtisë absorboi pjesëmarrjen më të lartë nga totali i totali i kredive për sektorin e shërbimeve me 73.4% të totalit të kredive për ndërmarrjet siç shihet në Figurën 4. sektori i industrisë (duke përfshirë minierat, prodhimin, industritë dhe ndërtimtarinë) shënoi 24.9% të totalit të kredive për ndërmarrjet në dhjetor 2011. Prodhimi dhe ndërtimtaria shënojnë 90% të totalit të kredive për sektorin e industrisë me një rritje prej 3 pikë përqindje krahasuar me periudhën e mëparshme.

Sidoqoftë, sektori i bujqësisë i cili merr pjesë me vetëm 3.5% në totalin e kredive në dhjetor të vitit 2011 (3.72% në nëntor 2010) vazhdon të ketë pjesëmarrjen më të ulët në totalin e kredive. Kjo përfaqëson konzervatizmin e sektorit bankar në lëshimin e kredive për sektorin e bujqësisë e cila është e karakterizuar edhe me normat më të larta të interesit duke reflektuar edhe pasigurinë të cilën e shohin bankat në këtë sektor e cila ndikon edhe në përqindjen shumë të ulët të kredive të lëshuara për këtë

sektor. Sektori i bujqësisë momentalisht është i paregjistruar dhe prezenca e informatave asimetrike kanë ndikuar që bankat ta shohin këtë sektor si jashtëzakonisht të rrezikshëm dhe si rezultat shumica e bankave nuk ofrojnë kredi për këtë sektor.

Figura 4. Struktura e kredive sipas sektorëve ekonomikë, në përqindje



Burimi: Raportet vjetore të BQK dhe Buletini i BQK

Aktiviteti i kredive për shumicën e sektorëve të ekonomisë u ngadalësua deri në vitin 2010 (shih Figurën 5), pastaj filloi të përmirësohet sidomos në sektorin e tregtisë dhe të shërbimeve tjera (duke përfshirë shërbimet hoteliere dhe restoranteve) përjetuan një rritje relativisht më të shpejtë dhe kështu vazhduan deri në fund të dhjetorit 2011.

Figura 5. Struktura e kredive sipas aktivitetit ekonomik dhe rritja e tyre ndër vite (në %)



Burimi: Raportet vjetore të BQK dhe Buletini i BQK

Prandaj, përderisa kreditë për sektorët tjera të ekonomisë patën një trend më të ngadalshëm të rritjes, rritja e përshpejtuar e kredive për ndërmarrjet në vitin 2011 mund të konsiderohet si rezultat i rritjes së shpejtë të kredive për sektorin e tregtisë

dhe shërbimeve tjera. Kreditë për sektorin e tregtisë në fund të dhjetorit 2011 arritën shumën 630 milion euro duke shënuar një rritje vjetore prej 16.6%. sektori i industrisë u karakterizua me një trend më të ngadalshëm të rritjes gjatë kësaj periudhe. Në fakt në dhjetor 2011 kreditë për sektorin e industrisë patën një rritje vjetore prej 5.7% krahasuar me 13.8% në dhjetor 2010 (shih Figurën 5).

Figura 6. Struktura e kredive sipas maturimit, në përqindje



Burimi: Raportet vjetore të BQK dhe Buletini i BQK (2011)

Kreditë për sektorin u ngadalësuan dhe kjo reflektoi në pengesën në "qasje dhe kosto për financim" të cilën shumë NVM e kanë deklaruar si shumë problematike. Sektori i bujqësisë në përgjithësi konsiderohet si një pjesë shumë e rëndësishme e ekonomisë dhe si një kontribuues shumë i madh në rritjen e BPV-së. sidoqoftë, ky sektor në Kosovë shihet si sektor me shumë risk dhe si rezultat shumë banka nuk lëshojnë kredi për këtë sektor. Kjo ndikon në ngadalësimin e rritjes të prezantuar në Figurën 5 ku totali I kredive për bujqësi në dhjetor 2011 ishte 40 milion euro.

Sa i përket maturimit të kredive, kreditë me kohë më të gjatë maturimi (2-5 vjet) vazhdojnë të dominojnë strukturën e totalit të kredive me 42.6% në dhjetor (shih Figurën 6). Kjo shifër mbetet e njëjtë me shifrën e vitit 2010. Megjithatë, shuma e totalit të kredive me afat maturimi mbi dy vjet përfaqëson 72.4% të totalit të kredive në të gjithë sistemin bankar ne dhjetor 2011 (edhe në dhjetor 2010 kjo shumë ishte 72.4%). Në anën tjetër, depozitat me afat maturimi nën dy vjet përfaqësojnë 82%.

3.1.3. Likuiditeti i Bankave

Sa i përket likuiditetit, 82% e depozitave në vitin 2008 ishin lëshuar si kredi për amvisëritë dhe ndërmarrjet. Në këtë rast, për herë të parë bankat komerciale e tejkaluan kushtin rregullativ për limitimin e kredisë të lëshuar nga BQK. Sidoqoftë, për shkak të krizës financiare globale, aktiviteti kreditues i bankave u ngadalësua (shih Tabelën 4) dhe vlera e depozitave në vitin 2009 dhe 2010 u zvogëlua në 75%. Megjithatë, deri tani këtë vit likuiditeti u rrit në 80.8% e cila edhe njëherë e kaloi kushtin e rekomanduar rregullator të lëshuar nga BQK. Nëse nuk ndërmerret ndonjë hap konkret parandalues nga BQK, ka gjasa që bankat ta ulin likuiditetin e tyre në vazhdimësi duke e tejkaluar limitin e tyre te lejuar.

Tabela 4: Pjesëmarrja e kredive, depozitave dhe aseteve në BPV (%)

Vitet	Kreditë/BPV	Depozitat/BPV	Asetet/BPV	Kreditë/Depozitat
2004	16.4	30.4	35.6	53.8
2005	16.8	27.4	32.2	61.4
2006	20.0	29.1	36.5	69.6
2007	26.1	33.4	41.8	78.1
2008	31.1	38.0	47.5	82
2009	32.9	39.9	53.3	73.9
2010	35.1	42.3	56.8	75.3
2011	38	47	59.5	80.8

Burimi: Raportet vjetore të BQK-se dhe raportet mujore, të dhëna nga FMN

Rritja e numrit të depozitave dhe bilancet e kredive të papaguara paraqesin dëshmi që sektori bankar në Kosovë vazhdon të kontribuojë në rritjen ekonomike të vendit duke e rritur rolin e vet si ndërmjetësues financiar. Kjo është evidente nga rritja e vazhdueshme disa indikatorëve si pjesëmarrja e aseteve të sektorit bankar, depozitat dhe kreditë në BPV. Sidoqoftë, këta indikatorë të paraqitur në Tabelën 4 kanë shumë më të ulëta krahasuar me regjionin. Pjesëmarrja e aseteve në BPV në dhjetor 2011 u rrit në afër 60% dhe nëse krahasohet me vitin 2005 (32.2%) pothuajse u dyfishua. Kjo erdhi si rezultat i rritjes se volumit të rritur të kredive nga sektori bankar që arriti 38% të BPV-së nga dhjetori 2011, gjithashtu rritjes së depozitave ku pjesëmarrja e tyre në BPV në dhjetor 2011 arriti 47%.

Norma e interesit – mesatarja e përgjithshme e normave të interesit në kredi në vitin 2011 ishte përafërsisht 14.15%, me një zvogëlim prej 45 pikë bazë krahasuar me 14.6% në vitin 2010. Tabela 5 gjithashtu e tregon që niveli mesatar i normës së interesit përgjatë viteve ka mbetur gati i njëjtë, me një ndryshim të vogël në vitin 2006 dhe me një rritje të vogël në 2008 dhe 2009.

Tabela 5: Normat e interesit[7] në kredi dhe depozita (%)

	Vitet	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011
A	Depozitat	2.5	3.2	3	3.3	4.2	4.3	3.7	3.5
B	Kreditë	14.2	14.2	13.4	14.6	14.8	14.4	14.6	14.15
C	Diferenca/ spredi i normave të interesit (C=A-B)	11.7	11	10.4	11.3	10.6	10.1	10.9	10.65

Burimi: Raportet vjetore të BQK 2004-20010, dhe raportet mujore të BQK

Mund të shihet se përderisa volumi i kredive është rritur çdo vit, normat e interesit krahasuar me rajonin kanë mbetur pamëshirshëm të larta sidomos për nevojat për investime afat-gjata kapitale. NVM-të të cilat në mënyrë që të ndjekin projektet e tyre për investime afat-gjate janë të detyruar të marrin kredi të cilat për shkak të normave shumë të larta të interesit janë shumë të pafavorshme. Megjithatë, është e rëndësishme të përmendet që normat e interesit për kredi dhe depozita kanë mbetur konstante. Kjo tregon që rritja e numrit të bankave në treg nuk ka ndikuar në intensifikimin e konkurrencës e cila më pas do të kishte ushtruar presion për zvogëlimin e normave të interesit në sektorin bankar në Kosovë. Portofolio e kredive në sektorin bankar në vend ka vazhduar të jetë e një kualiteti të lartë. Pavarësisht nga rritja e shpejtë e kredive në shtator 2011, pjesëmarrja e kredive jo-performuese (KJP) në totalin e kredive (e cila përfshinë kreditë të cilat klasifikohen si të "dyshimta" dhe me "humbje") ishte relativisht e ulët me 6%. Kjo shifër ishte shumë e përafërt edhe në 2010 me 5.9% (shih Figurën 7). Pjesëmarrja e KJP-së në totalin e kredive ishte 6% në 2011 dhe kjo e renditë Kosovën mesataren prej 15% sa është shënuar në vendet e rajonit. Kjo tregon se portofolio e kredive në sektorin bankar në Kosovë në përgjithësi ka kualitet më të mirë krahasuar me vendet e rajonit. Bazuar në madhësinë e bankave, rezulton që bankat e mëdha kanë kualitet më të mirë të protofoliove të kredive krahasuar me bankat më të vogla.

Figura 7. Pjesëmarrja e KJP ndaj kredive totale (%)



Burimi: Raporti vjetor i BQK dhe buletinet e BQK

7 Shpërndarja e lëvizjeve të mesatares vjetore të normave të interesit nëpër produkte dhe maturime të ndryshme.

Gjatë vitit 2011, tri bankat më të mëdha regjistruan raportin e KJP ndaj kredive totale në 4.2%, përderisa bankat tjera, në mesatare, regjistruan raport 8.1% të KJP ndaj portofolit të kredive të tyre. Lidhur me ndarjen në sektore, kreditë familjare kanë nivelin më të ulët të KJP. Tabela 6 tregon që Kosova posedon numrin më të vogël në rajon të kredive për sektorin e NVM-ve në raport me BPV-në e vendit. Gjithashtu norma e interesit për kreditë një vjeçare, tregon që janë më të lartat në mesin e të gjitha vendeve nga regjioni, indikator i cili tregon që kreditë në Kosovë janë më të shtrenjtat në rajon. Kjo tregon që ekzistojnë oferta të dobëta për NVM-të dhe intensitet të ulët kreditor i cili lidhet me normat e larta të interesit krahasuar me vendet e rajonit. Në anën tjetër raportet e profitit në vitin 2011 janë më të mirat në rajon.

Tabela 6. Treguesit e linjës kreditore për vendet në tranzicion në vitin 2011 (%)

	Sektori i NVM-ve Kreditë/BPV	Normat e interesit		Kreditë e këqija (Kreditë në total)
		Depozitat	Kreditë (< 1 jeçare)	
Kosova	28.3	3.5	14.15	5.9
Shqipëria (në euro)	41.2	2.16	6.88	18
Bosnia	46.0	p/p	p/p	11
Serbia	47.5	4.1	11.0	19
Maqedonia	49.9	5.3	9.9	8.5
Mali i zi	121.2	4.8	9.2	25

Burimi: Raporti i tranzicionit EBRD, vlerësimi i BPV për Kosovën nga FMN dhe Raporti vjetor i BQK

Kthimi i kapitalit (ROE) për Kosovën arriti 11.2% në vitin 2011, shifër e cila është mbi mesataren e regjionit (4%) dhe mbi mesataren e ROE të shteteve tjera në sektorin bankar (shih Tabelën 7). Për më tepër, kthimi në asete (ROA) gjithashtu ka performuar mbi mesataren regjionale, përderisa në vitin 2011 ajo qëndroi në 1% dhe, me përjashtim të Serbisë, asnjë shtet tjetër nuk ka performuar më mirë.

Duke marrë parasysh krizën e borxheve Evropiane e cila ishte reflektuar kryesisht në sistemin bankar, duket që bankat komerciale në Kosovë nuk janë ndikuar aq shumë, për më tepër edhe gjatë këtyre periudhave kanë vazhduar të tregojnë performancë të mirë financiare. Megjithatë, duhet theksuar që në Kosovë kjo është arritur me intensitet të ulët kreditor (kredia/në raport me BPV), nëpërmes diferencës në mes të normës së interesit për kredi dhe normave të interesit për depozita që është më e larta në rajon. Përderisa performanca pozitive e bankave në Kosovë është e mirëseardhur duke marrë parasysh krizën e borxheve të Eurozonës, aspekti negativ i kësaj është se bankat komerciale kanë vazhduar të mbajnë normat e interesit më të lartat në rajon, e cila është pengesë e madhe për zhvillimin e NVM-ve. Duke marrë parasysh faktin që bankat janë mësuar me norma të larta të interesit, ne mendojmë që çdo bankë e re që hyn në treg do të krijoj një valë shoku pasi që konkurrenca në sektorin bankar do të rritet, dhe për shkak të pozitës komode që bankat komerciale duket se kënaqin, kjo mund të jetë diçka që nuk do të ju pëlqente bankave.

Tabela 7: Raporti i profitabilitetit për vitin 2011 (në %)

Shtetet	ROA	ROE
Kosova	1.4	14.5
Shqipëria	0.2	2.5
Bosnia	0.3	3
Serbia	1.5	6
Maqedonia	0.1	1
Mali i zi	-0.8	-6
Mesatarja e regjionit	0.3	4

Burimi: Raportet e bankave qendrore të shteteve në fjalë

Megjithatë, kur vlerësohen indikatorët e performancës si ROA dhe ROE vetëm për tri bankat më të mëdha në Kosovë, këta indikatorë tregojnë profit edhe më të madh që gjenerohet nga këto banka, ku 90.1 % të neto profitit total të sektorit bankar vjen nga tri bankat më të mëdha. Kthimi në asete në fund të vitit 2011 vetëm për tri bankat më të mëdha, shënoi 1.81 % e cila është më e madhe se ROA e sektorit bankar në Kosovë, dhe më e madhe se gjashtë herë mesatarja e regjionit (siç shihet në Tabelën 7). Ndërsa, kthimi në kapital (ROE) në vitin 2011 nga tri bankat më të mëdha, shënoi rritje për 16.33 %; shumë më tepër se mesatarja e sektorit në Kosovë, dhe katër herë zhvillimi i mesatares së regjionit.

Mund të argumentohet që kushtet e tregut kanë qenë të favorshme për këtë, por prapë mbesin të analizohen nëse qeveria e Kosovës, agjencitë rregullative, BQK, bankat komerciale, dhe shoqatat tjera biznesore kanë krijuar kushtet për konkurrencë të lirë më të lartë në tregun e kredive, nëse ata marrin masa të nevojshme për zvogëlimin e riskut, nëse ka furnizim dhe ofertë të mjaftueshme të kredive, apo të gjitha bankat janë komode me kushtet momentale të tregut të kredive. Mund të shtrohet pyetja nëse kjo është e mirë për nevojat e zhvillimit afatgjatë të ekonomisë së Kosovës, në një situatë që është vështirë për financimin afatgjatë të bizneseve dhe nevojave afatgjata të zhvillimit. Është e qartë që në fund bankat ndajnë fatin e klientëve të tyre, bizneset dhe familjet, dhe duket që në këtë relacion duhet të ketë më tepër mendim praktik.

3.1.4. Kredi hipotekare

Sa i përket maturisë, gjatë vitit 2011 interesi më i lartë prej 16.1 përqind është regjistruar nga kreditë hipotekare me maturi për më pak se pesë vjet, duke shënuar një rritje vjetore rreth 2 pikë përqindje (Tabela 8). Normat e interesit në kreditë hipotekare me pesë deri në dhjetë vjet maturitet gjatë 2011 qëndruan në 11.99 %, duke shënuar një rritje prej 83 pika bazike (basis points) krahasuar me periudhën e njëjtë paraprake (11.99 % gjatë 2010). Për më tepër, ne shohim kreditë hipotekare me më tepër se dhjetë vjet maturitet duke regjistruar 10.83 % pra duke shënuar një rritje të vogël prej 9 pika bazike (basis points) krahasuar me periudhën e njëjtë paraprake (10.73 % gjatë 2010).

Tabela 8. Normat e interesit për kreditë hipotekare

Kredi shtëpiake				
Vitet	Kreditë konsumatore	Kredi Hipotekare		
		<= 5 vite	> 5 vite dhe<= 10vite	> 10vite
2007	13.03	12.94	11.34	*
2008	13.78	11.16	11.25	10.93
2009	12.88	10.87	11.25	9.20
2010	14.56	14.15	11.16	10.74
2011	14.02	16.1	11.99	10.83

Burimi: Raporti vjetor i BQK dhe buletinet e BQK (2011)

Normat e interesit në kreditë hipotekare me pesë deri në dhjetë vjet maturitet gjatë vitit 2011 qëndruan në 11.99 %, duke shënuar një rritje prej 83 pika bazike (basis points) krahasuar me periudhën e njëjtë paraprake (11.99 % gjatë 2010). Krahas kësaj, ne ashtu shohim kredi hipotekare që me më tepër se 10 vjet maturitet regjistrojnë 10.83 % duke shënuar një rritje të vogël prej 9 pika bazike (basis points) krahasuar me periudhën e njëjtë paraprake (10.73 % gjatë 2010). Krahas kësaj, ky lloj i kredisë hipotekare shënoi normat më të ulëta të interesit krahasuar me lloje tjera të kredive hipotekare. Megjithatë, kërkesa më e lartë për kreditë hipotekare është paraqitur për ato që janë më të vogla se pesë vite. Kjo tregon që për shkak të sistemit gjyqësor jo-efiçient i cili ekziston në Kosovë, kur vie tek ekzekutimi i kolateraleve të kredisë kjo kryesisht merr vite të tëra, andaj bankat shohin sektorin e kredive familjare si sektor më të rrezikshëm, prandaj ekzistojnë normat e larta të interesit për kreditë hipotekare. Tabela 8 gjithashtu tregon që kreditë konsumatore në dhjetor të vitit 2011 qëndruan në 14.02 %, duke shënuar 1% rritje vjetore prej 54 pika bazike (basis points).

3.1.5. Aplikimet për licencimin e bankave të reja

Numri i bankave komerciale në tregun financiar në Kosovë mbeti i pandryshuar gjatë tri viteve të fundit, pavarësisht nga fakti që kjo industri konsiderohet të jetë shumë profitabile dhe vazhdimisht i ka zgjeruar aktivitetet, e cila paraqet faktorë të rëndësishëm për tërheqjen e institucioneve të reja financiare për të hyrë në treg.

Megjithatë, sipas BQK-së, mungesa e hyrjeve të bankave të reja në tregun financiar në Kosovë gjithashtu korrespondon me zhvillimet e krizës financiare globale që nga viti 2008, e cila ka limituar zgjerimin e mëtutjeshëm të institucioneve financiare të huaja ndaj tregjeve të reja. Një ndikim i njëjtë është duke u shkaktuar nga kriza momentale e borxheve publike në Eurozonë, e cila ka goditur një numër të madh të bankave në Unionin Evropian. Përveç kësaj, janë shumë pengesa për bizneset në Kosovë të cilat konsiderohen si skajshmërisht të pafavorshme dhe mund të kontribuojnë në mungesën e interesimit nga investitorët tjerë të investojnë në Kosovë.

3.1.6. Çështjet kadastrale

Kur u intervistuan bankat komerciale dhe kur u pyetën për arsyet e normave të larta të interesit, përfaqësuesit e bankave listuan një numër të pengesave, dhe në mesin e tyre ishte poashtu mungesa e regjistrimit të apartmaneve, dhe ndërmarrjeve. Kjo sipas bankave prezantonte probleme reale duke u bazuar në faktin që pronarët e apartmaneve/ndërmarrjeve nuk kishin leje posedimi të apartmaneve apo ndërmarrjeve, duke e bërë të pamundur për këta pronarë të përdorin apartmanet apo ndërmarrjet e tyre si kolateral kur aplikojnë për kredi. Po të kishin certifikatë posedimi të apartmaneve apo ndërmarrjeve të tyre, ata do të ishin në gjendje t'i ofronin ato si kolateral, dhe bankat në kthim do t'u ofronin këtyre pronarëve kredi bankare me norma interesi më të ulëta.

Agjensioni Kadastral i Kosovës në koordinim me Bankën Botërore ka zhvilluar një projekt ku ka bërë regjistrimin në masë të madhe duke përfshirë 12,000 apartmane dhe ndërmarrje në katër qytete të Kosovës: Prishtinë, Prizren, Pejë, dhe Gjilan. Këto qytete ishin prioritet pasi që posedojnë numrin më të madh të apartmaneve në Kosovë. Megjithatë, kjo paraqet vetëm fazën e parë të projektit që do të thotë në fazat tjera, projekti pritet të zgjerohet duke përfshirë vende tjera të Kosovës. Regjistrimi në qytete tjera të Kosovës planifikohet të përfundojë deri në fund të vitit 2013.

Certifikimi si rezultat i këtij projekti, përpos përparësive tjera, gjithashtu do të ofrojë benefite për sistemin bankar në Kosovë. Kjo do t'u ofrojë siguri bankave komerciale dhe si e tillë mund të kontribuojë në uljen e normës së lartë të interesit. Që nga përfundimi i fazës së parë të këtij projekti 12,000 pronarëve i janë dhënë certifikata. Efektet e regjistrimit në sektorin bankar sa i përket normave më të ulëta të interesit mund të testohen në të ardhmen e afërt.

4. Sektori Bankar: Gjetjet nga Anketat

4.1 BQK dhe Bankat Komerciale – Rezultatet e Anketave dhe Analizat nga intervistat

Për të ofruar rezultate të besueshme me qëllimin e konsiderimit të pikëpamjes të të gjitha palëve të interesit, Instituti Riinvest gjithashtu intervistoi bankat komerciale në Kosovë. Nga tetë bankat që operojnë në Kosovë, me përjashtim të "Banka Ekonomike" dhe "Komercijalna Banka", intervista personale janë zhvilluar me përfaqësues të bankave nga një hulumtues senior i Institutit Riinvest.

Kur bankat komerciale u pyetën për vlerësimet e tyre të gjendjes aktuale të sistemit bankar në Kosovë në relacion me sistemet bankare të regjionit, dhe duke konsideruar faktin që sistemi bankar në Kosovë është ndërtuar në vitin 2000, të gjitha bankat e intervistuara në përgjithësi e konsiderojnë sistemin bankar të jetë shumë i shëndoshë dhe stabil. Gjithashtu bankat mendojnë që stabiliteti i sistemit bankar është për shkak të kritereve të avancuara dhe procedurave që bankat aplikojnë kur vlerësojnë aplikimin e kredive në përgjithësi. Për më tepër, ata gjithashtu theksojnë rolin shumë të rëndësishëm të BQK-së për ruajtjen e implementimit të origjina e kredisë (credit origination) në mënyrë adekuate dhe të matur, në mbledhjen dhe përpunimin e portofoleve kreditore me kualitet të lartë në sektorin bankar. Një pikëpamje tjetër e bankave është që, fillimisht kur sistemi bankar është ndërtuar në vitin 2000, nuk kishte konkurrencë në sistemin bakar dhe tani janë tetë banka që operojnë në Kosovë, dhe për momentin ata duken të jenë të lumtur dhe rehat me nivelin e konkurrencës në këtë sektor. Gjithashtu duke u bazuar në përgjigjet e bankave, niveli i KJP dhe kualiteti i lartë i portofolave mundëson që ky sistem në Kosovë të jetë më i sigurti dhe më i shëndoshi në rajon. Duke u bazuar në bankat komerciale, mungesa e bankave Greke në Kosovë dhe mungesa e tregtisë që Kosova (bankat komerciale në Kosovë janë kryesisht pronë e shteteve Perëndimore Evropiane dhe shumica e tregtisë bëhet me këto shtete, përfshirë Kinën dhe SHBA) bën me Greqinë, ka krijuar krijuar një avantazh për ne, duke e ekspozuar vendin më pak ndaj riskut, në kontrast me shtetet e rajonit (Maqedonia, Shqipëria, etj.) të cilët bëjnë shumë tregti me Greqinë. Bankat Greke në sektorin bankar të shteteve fqinje, ekspozojnë sistemin bankar edhe më tepër ndaj riskut të bankrotimit bankar për shkak të problemeve të borxheve që kanë bankat Greke.

Edhe zyrtarët e BQK pajtohen me vlerësimin e bankave komerciale në këtë rast. Ata mendojnë që pa marrë parasysh faktin që sistemi bankar në Kosovë është i ri (12 vjet) krahasuar me shtetet fqinje, ky sistem sa i përket shërbimeve dhe produkteve financiare që ofron, ka mundur të konsolidohet shumë mirë. Shumica e indikatorëve, si niveli i KJP, niveli i produkteve financiare dhe shërbimeve tregojnë një sistem shumë të shëndoshë bankar.

Bankat ishin pyetur se pse, bazuar në perceptimet e bizneseve, normat e interesit të kredive ishin tejet të larta dhe të papërballueshme për bizneset, dhe nuk duket se kanë ndryshuar shumë që nga krijimi i sistemit bankar në Kosovë 12 vjet më

parë. Përgjigjja e bankave ishte që bizneset janë të keqinformuara nëse mendojnë që normat e interesit janë shumë të larta, sepse vetë bankat nuk i klasifikojnë ato si të larta duke marrë parasysh faktin që normat e interesit gjithnjë kanë qenë në trend të rënies që nga vendosja e sistemit bankarë në Kosovë. Bazuar në faktet e dhëna në Tabelën 5, këto deklarata të bëra nga bankat nuk duken të sakta. Megjithatë, bazuar në bankat komerciale, një numër i faktorëve merren në konsideratë kur ata vlerësojnë aplikacionin për kredi të një biznesi. Specifikisht, këta faktorë janë vendimmarrës nëse kredia për biznes do të ketë interes të lartë apo të ulët, dhe ata janë:

- Niveli i rrezikut shtetëror (tradita, efiçienca institucionale, korrupsioni, sistemi gjyqësor, ekonomia jo-formale, niveli i relacioneve shtetërore me FMN, BERZH etj.),
- Niveli i riskut qe ka të bëjë me kompaninë (risku specifik ose risku stand-alone), si dhe sektorit që i përket (disa sektorë janë më të rrezikshëm se disa tjerë),
- Nëse gjendja financiare e kompanisë auditohet apo jo; kualiteti i analizave financiare, reputacioni i auditorit i cili ka certifikuar analizat financiare të kompanisë (nëse është kompani profesionale e auditimit). Duhet theksuar që shumë kompani në Kosovë nuk posedojnë analiza financiare të audituara.
- Regjistrimi i punëtorëve të kompanisë me "ATK – Administrata Tatimore e Kosovës" (ku bazuar në banka shumica e kompanive, ose nuk i regjistrojnë punëtorët në ATK, ose regjistrojnë vetëm disa nga punëtorët e tyre, dhe në kthim bankat kanë nevojë të hulumtojnë këto kompani më thellësisht gjë që e bën vendimin bankar më të shtrenjtë),
- Probleme që hasen me Agjensionin Kadastral të Kosovës – AKK (pronarët nuk janë në gjendje të përdorin pronat e tyre si kolateral për shkak të mungesës së regjistrimit të pronës nga AKK, gjë që e bën të pamundur për këta pronarë të përdorin apartmanet/tokat si kolateral kur aplikojnë për kredi bankare, gjë që rezulton në norma të larta interesi.
- Kosto të larta operative (në shumicën e rasteve bizneset nuk posedojnë të gjitha informatat e nevojshme për bankën për të marrë vendime për kredi, duke e bërë të nevojshme për bankën që të bëjë kontrolle të shumta të këtyre kompanive, dhe në kthim rritë kostot operative të saj),
- Biznes planet e kompanive (sipas bankave, shumë shpesh NVM kërkojnë kredi pa Biznes Plan, ose nëse posedojnë Biznes Plan, ai është zhvilluar dobët),
- Kosto e depozitave (e cila mesatarisht është në mes 4-5 %) të cilat bankat komerciale u paguajnë depozitorëve, plus norma e interesit e cila është skajshmërisht e ulët (0.5-0.6 %) të cilën e fitojnë në rezervat obligative që i vendosin me BQK, gjë që e bën koston e depozitave edhe me të lartë),
- Lloji i kredisë nga klienti, madhësia e biznesit, qëllimi, lloji i maturimit, etj. (nëse kredia është afat-gjatë, afat-shkurtë, e madhe apo e vogël, a është e destinuar për qëllime investive apo për kapital punues, etj.). Zakonisht, sa më e madhe dhe sa më afat-gjate që është kredia biznesore, më e vogël është norma e interesit),
- Sistemi gjyqësor (sipas bankave, sistemi gjyqësor i Kosovës është jo-efiqient dhe shumë i ngadalshëm në zgjedhjen e rasteve),
- Lloji dhe kualiteti i kolateralit që përdoret për të siguruar kredinë dhe procedurat e zbatimit të kolateralit në Kosovë (kur kreditë janë të pa paguara - defaulted, atëherë bankat përmes gjykatës mundohen të marrin pronësi mbi kolateralin (shtëpinë, apartmanet), dhe ajo merr vite (rreth 2-4 vite) për gjykatën që të marrë vendime për likuidimin e kolateralit të kredisë, edhe pas kësaj, kolaterali i cili shpallet në ankand publik në shumicën e rasteve nuk likuidohet për shkak

të kulturës ku njerëzit ngurrojnë të blejnë një pronë e cila është në posedim të bankës, ose ndoshta pronarët bëjnë presion tek blerësit potencial që të mos blejnë pronat e tyre),

- Niveli i kredive jo-performuese (sa më i vogël numri i KJP, më i vogël është risku i ekspozimit të sektori bankar, dhe sa më i madh numri i depozitave në dispozicion për t'u ofruar NVM-ve për kredi), e cila për momentin është më e mira në regjion,
- Rezervat e nevojshme të depozitit kanë raport prej 10 % (e vendosur nga BQK) që të mbahet tërë kohën në bankat komerciale,
- Norma EURIBOR[8] dhe norma LIBOR[9],

Andaj sipas bankave komerciale, një kombinim i të gjithë faktorëve të cilët u përmenden më lartë merret në konsideratë kur normat e interest të kredive kalkulohen. Dhe sipas bankave komerciale, arsyeja që normat e interesit në Kosovë janë më të lartat në rajon, është për shkak se shtetet fqinje në çdo pikë të përmendur më lartë me përjashtim të KJP, profitabilitetit bankar dhe riskut, qëndrojnë shumë më mirë se Kosova, dhe duke pasur risk më të ulët të ambientit biznesor dhe norma më të ulëta interesi sesa ne. Një pikëpamje tjetër e bankave komerciale është që, ambienti binzesor në Kosovë është kryesisht (96 përqind) i ndërtuar nga biznese të vogla, dhe ata duket se më së tepërmi kërkojnë kredi të vogla apo mesatare dhe afatshkurtë, dhe sa më i vogël maturiteti i kredisë më i madh risku dhe sa më e lartë do të jetë norma e interesit.

Përderisa BQK në pyetjen e njëjtë se pse normat e interesit perceptohen që janë shumë të larta nga bizneset dhe familjet njëkohësisht, ata mendojnë që sistemi bankar është shumë i ndjeshëm dhe ajo mbështetet shumë në efektivitetin e sistemit gjyqësor në Kosovë. Sipas hulumtimit të BQK, sistemi gjyqësor në Kosovë vuan nga një shkallë e lartë e jo-efiçiencës, që do të thotë vonesa të mëdha (2-3 vite së paku) në zgjedhjen e çështjeve që vijnë nga bankat komerciale, si dhe vonesa të mëdha në ekzekutimin e kolateralit. Një çështje tjetër shqetësuese janë problemet e shumta që ekzistojnë në sektorin real të ekonomisë, si mungesa e auditimit dhe raportimeve financiare të bizneseve, ku bankat janë shtyrë të refuzojnë shumë aplikacionet për kredi të bizneseve duke u bazuar në faktin që ata nuk i konsiderojnë këto biznese të besueshme, ose në raste ku aplikacioni i kredisë është pranuar, bankat shpenzojnë shumë kohë dhe burime për ti verifikuar këto analiza financiare që ofrohen nga kompanitë, dhe kjo përkthehet në norma më të larta interesi. Mungesa apo zhvillimi i dobët i biznes planeve bën që kompania të jetë e rrezikshme nga perspektiva bankare, si dhe problemet kadastrale (njerëzit që nuk janë në gjendje të certifikojnë apartmanet, pronësia e tokës) gjithashtu kontribuojnë në norma më të larta të kredisë. Një çështje tjetër është gjithashtu koncentrimi i tregut, edhe pse në trend të rënies, ende konsiderohet të jetë shumë i lartë.

8 **Norma EURIBOR –** qëndron si shkurtesë për Norma Orfertuese e Euro InterBank. Normat Euribor janë të bazuara në normën mesatare të interesit në të cilin një panel prej më tepër se 50 Bankave Europiane marrin fonde hua nga njëri tjetri. Egzistojnë maturitete të ndryshme, që varirojnë nga një javë deri në një vit. Normat e interesit ofrojnë bazën për çmimin dhe shkallën e interesit për të gjitha llojet e produkteve financiare si llogaritë e kursimeve dhe kredive hipotekare.

9 **Norma LIBOR** - LIBOR është akronim për Norma Orfertuese e London InterBank. LIBOR ndërtohet nga Asociacioni Bankar Britanez (ABB), dhe është norma e interesit që banakt paguajnë njëri tjetrit për kredi një muaj, tri muaj, gjashtë muaj dhe një vit. Kjo normë është ajo e cila ngarkohet nga bankat Londoneze, dhe pastaj publikohet dhe përdoret si shkallë krahasuese për normat bankare në gjith botën.

Për më tepër, bankat komerciale gjithashtu deklarojnë që dështimi më i madh i normës kreditore lidhet me NVM-të, sepse një numër i madh i tyre janë të bankrotuar vetëm pas një periudhe të shkurtër operimi, dhe sipas bankave kërkesa për kredi të vogla apo të mesme afatshkurtra është rritur konsiderueshëm, kjo ka kontribuar në rritjen e normës së interesit. Kërkesa për kredi afatgjate ka rënë pasiqë në vitet e fundit ka rënë edhe numri i bizneseve të mëdha të cilat kërkojnë kredi për investime. Bankat gjithashtu potencojnë që kur është ndërtuar sistemi bankar, kishte shumë pak produkte në dispozicion, normat e interesit qëndruan në 24 % dhe kreditë maksimale që mund të merreshin kanë qenë 100,000 DM, ndërsa tani sistemi bankar është shumë më i avancuar me shumë biznese dhe produkte të konsumatorëve, dhe mesatarja e normave të interesit është rreth 14.3%. Megjithatë, të dhënat e BQK nuk pajtohen me deklaratat e bankave komerciale, sepse sipas raporteve vjetore të BQK, normat e interesit të kredisë në 2001 (ishin shtatë banka komerciale duke operuar) qëndruan në 16 %, përderisa normat e interesit të depozitave ishin 2.5 %. Këto norma të larta të interesit vazhduan të bien deri në 2003, duke u nivelizuar në 14.6%, të cilat deri në këtë ditë kanë mbetur gati të njëjta. Përderisa normat e interesit të depozitave janë rritur në vitet e fundit, tani bankat ofrojnë rreth 3.5 % për depozita të konsumatorëve dhe bizneseve.

Kur bankat u pyetën nëse mund të pritet që normat e interesit të bien në të ardhmen e afërt, ose nën cilat rrethana ata do të bindeshin t'i ulnin normat e interesit të kredive, përgjigja e tyre ishte që normat e interesit të kredive janë në trend të rënies për klientët performues, sepse pasi që një klient përfundon me sukses kredinë e parë, kredia e dytë jepet gjithashtu me interes më të ulët (1-2 %), që do të thotë që klientët të cilët performojnë mirë shpërblehen me norma më të ulëta interesi, dhe klientët të cilët nuk performojnë mirë ose refuzohen ose u jepen kredi me norma më të larta interesi. Duhet theksuar që na mungojnë të dhëna të mjaftueshme për të verifikuar deklaratat e mësipërme nga bankat. Sistemi gjyqësor i Kosovës gjithashtu luan një rol të rëndësishëm, dhe sipas bankave, sa më efiçiente dhe efektive që bëhen gjykatat, më të sigurta do të jenë investimet tona dhe rrjedhimisht më të ulëta normat e interesit. Një tjetër faktor i rëndësishëm për bankat që mund të ulë kostot e tyre operacionale dhe kështu të kontribuojë në uljen e normave të interesit për kreditë, është ulja e ekonomisë jo-formale me projekte qeveritare duke u ofruar bizneseve arka fiskale, sepse sa më i madh numri i bizneseve që përdorin kupona fiskalë më lehtë është për bankat të zhvillojnë analizën e kredive, dhe më pak të rrezikshme janë kreditë. Gjendjet e bilancit të cilat janë të audituara, dhe punëtorë të regjistruar me ATK janë një fakt tjetër i cili do të kontribuojë në bërjen e kompanive më të besueshme dhe më të sinqerta, dhe kjo do të kontribuojë në uljen e normave të interesit. Ndikim shtesë në uljen e normave të interesit për kredi do të kenë po ashtu regjistrimi i apartmaneve dhe ndërmarrjeve nga Agjensioni Kadastral i Kosovës (AKK), në të cilin rast këta pronarë do të jenë në pozitë të marrin certifikatë pronësie nga AKK, e cila në kthim do t'ju ofrojë mundësinë që t'i përdorin pronat e tyre si kolateral në shkëmbim për një normë më të ulët interesi.

Kur është pyetur BQK, çfarë duhet të bëhet në mënyrë që të ulen normat e interesit në tregun në kredive, edhe ata gjithashtu u pajtuan me vlerësimin e bankave komerciale, që një përmirësim i përgjithshëm i ambientit biznesor[10] definitivisht do të tërhiqte hyrës të rinj në tregun e Kosovës, ku bankat duhet të jenë më konkurruese apo efiçiente,

10 Përmirësimi i efiqiencës së sistemit gjyqësorë, ulja e ekonomisë informale, implementimi i regjistrimit të apartmaneve në Agjensionin Kadastral, shtëpitë, dhe parcelat në Agjensionin Kadastral , etj.

dhe kjo do të ulë kostot operacionale të bankave, dhe në kthim do të ulte gjithashtu normat e interesit.

Duke konsideruar faktin që raporti në mes të kredive dhe depozitave në Kosovë që nga dhjetori i vitit 2011 qëndroi rreth 80.8%, bankat komerciale gjithashtu u pyetën për kualitetin e kërkesës së kredive, dhe nëse ato kanë potencialin për rritjen e volumit të kredive, pasi që ato vetëm sa i kanë kaluar limitin e rekomanduar margjinal të vënë nga BQK (në 80 %). Duke pasë parasysh faktin që kërkesa për kredi është për ato afat-shkurta, bankat komerciale në përgjithësi deklaruan që deri në ¼ e portofolit të kredive të tyre e kthejnë gjatë vitit, dhe se ata duhet të lëshojnë kredi gjatë tërë kohës, në të kundërtën raporti i tyre i kredive me depozitat në cilindo muaj mund të bie në mënyrë të konsiderueshme (deri në 50 – 60 % të raportit kredi/depozitë), që do të thotë që potenciali i tyre për kredi mbetet i lartë. Megjithatë, sipas bankave, aftësia e tyre për të rritur kreditë në treg ka arritur limitin maksimal. Kërkesa e vogël për kredi afatgjata nga NVM-të tregon që ato nuk kanë perspektivë afatgjate andaj kërkojnë më shumë kredi afatshkurta vetëm që të ekzistojnë. Mbi të gjitha, kualiteti i kërkesës së kredive edhe pse shumë i filtruar, shumë shpesh klasifikohet si i varfër për shkak të shumë informaliteteve si dhe mungesës të planeve investuese nga NVM-të të cilat aplikojnë për kredi biznesi.

BQK mendon që duke marrë në konsideratë nivelin e informalitetit në Kosovë, është shumë e vështirë të vlerësohet kualiteti i kërkesës së kredive. Sa i përket bankave të cilat e rrisin potencialin e tyre të kredive, BQK potencon se të gjitha bankat në Kosovë, kanë potencial të rrisin nivelin e kredive në treg, duke marrë parasysh faktin që niveli i rezervave likuide që mbahet nga bankat vazhdimisht ka tejkaluar kërkesat. Kjo rezervë në teprica mund potencialisht të jepet me kredi në treg, megjithatë sipas bankave, ato gjithashtu hasin në mungesë të projekteve investive adekuate të cilave mund t'u ofrohen kredi. Kjo mund të jetë arsyeja pse bankat kanë tejkaluar nivelin e rezervave likuide dhe nuk janë të gatshëm t'i përdorin ato. Lidhur me raportin kredi-depozita, norma prej 80 % është e rekomanduar nga BQK, dhe është normë mesatare e rekomanduar e cila mund të varijojë nga banka në bankë, varësisht në vlerësimin e bankës bërë nga BQK. Sa i përket raportit të limitit të depozitave të kredive, ky raport mund të varijojë nga banka në bankë varësisht nga burimet e fondeve, kualitetit të portofolit të kredive, etj. Që do të thotë që bankave të cilat përdorin burime të jashtme financiare, mund t'u lejohet një raport më i lartë kredi-depozit. Pa marrë parasysh madhësinë e bankës, qasja e BQK është jo-diskriminuese dhe absolutisht e njëjtë për të gjitha bankat, deklaroi përfaqësuesi i BQK. Të gjitha bankat që operojnë në Kosovë janë subjekt i rregullatorit dhe procedurave të njëjta mbikëqyrëse. Megjithatë, bankat e huaja në Kosovë kanë mundësinë të marrin linja kredie tërë kohën nga bankat e tyre amë nëse vendosin ta bëjnë një gjë të tillë, andaj ato mund të krijojnë burime të reja të cilat mund të përdoren për kredi ndaj NVM-ve nëse do të kishte kërkesë të mjaftueshme në treg.

Bankat komerciale janë pyetur për normën bazë të cilën e përdorin për të përcaktuar normat e interesit në Kosovë dhe për mendimin e tyre lidhur me faktin se a janë normat e interesit për kredi të përballueshme nga bizneset dhe familjet. Gjatë përcaktimit të normave të interesit për kredi bankat në Kosovë përdorin normën e EURIBOR-it dhe LIBOR-it, pavarësisht nga fakti që këto norma kanë shumë pak ngjas-

hmëri apo janë shumë pak të lidhura me kostot e fondeve të bankave në Kosovë. Sa i përket mundësisë për të përballuar normën e kredive, përgjigja e bankave ishte se duke pasur parasysh performancën e lartë të këtyre kredive, normën e lartë të kthimit të kredive dhe normën e lartë të kërkesës për kredi, normat e interesit në kredi janë të përballueshme.

Hapja e Byrosë për Regjistrimin e Kredive, e cila është themeluar në 2006 nga BQK dhe financuar që atëherë nga i njëjti institucion dhe ku secila kredi e lëshuar nga bankat komerciale regjistrohet, konsiderohet si hap shumë i rëndësishëm nga bankat komerciale për të mënjanuar rrezikun kreditor pasi që bankat i marrin informacionet e azhurnuara nga kjo byro. Sipas BQK-së dhe bankave komerciale, para se të aprovohet një kredi, çdo bankë apo institucion mikrofinanciar konsultohet me Byronë për Regjistrimin e Kredive për të kuptuar nëse personi i cili po aplikon për kredi ka kredi me bankat e tjera dhe kjo informatë është shumë e rëndësishme pasi që e përshkruan historinë dhe bonitetin të një klienti dhe në këtë mënyrë kontribuon në zvogëlimin e rrezikut ndaj mospagimit të kredisë.

Është e rëndësishme të ceket se Qeveria e Kosovës planifikon të emetojë letra me vlerë gjatë vitit 2012 në disa faza dhe në shumë prej 74 milion euro. Faza e parë e emetimit të letrave me vlerë ka filluar në Janar të 2012-ës ku 10 milion euro janë emetuar dhe vetëm bankat komerciale kanë pasur të drejtën të investojnë. Gjithashtu, përmes bankave komerciale Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe AKP-ja mund të jenë të interesuar të investojnë në këto letra me vlerë. Zyrtarët nga bankat komerciale mendojnë se këto letra me vlerë mund të kenë ndikim indirekt në normat e interesit. Pasi që bankat nuk fitojnë shpërblim në rezervat e tyre, BQK dhe bankat mendojnë që rezervat shtesë (duke përjashtuar 10 % të rezervave të depozitave të detyrueshme me ligj) të bankave do të përdoren për të investuar në letra me vlerë dhe në këtë mënyrë do të sigurojnë kthim më të madh në investim (norma e interesit për letrat me vlerë të emetuara në fazën e Janarit ka qenë 3.51%). Kjo do të ndikojë në uljen e kostos së financimit për bankat dhe si rezultat mund të ndikojë në uljen e normave të interesit. Një koment tjetër nga bankat është që përmes letrave me vlerë, Qeveria e Kosovës do të rrisë buxhetin dhe konkurrenca në sektorin financiar dhe konkurrenca në ekonomi në përgjithësi do të rritej pasi që banka dhe institucionet e reja financiare do të hyjnë në treg.

Sipas bankave dhe BQK-së, një ngritje në nivelin e aftësive për të përpiluar një plan biznesi nga ana e kompanive, do të ndikojë në normat e interesit. Arsyeja qëndron në faktin se sa më shumë njohuri që kompanitë kanë për të përpiluar plan biznesi, aq më të mëdha janë gjasat që kompanitë të kenë dokumentet e kompletuara (dokumentet si regjistrimi i punëtorëve me ATK, raporte financiare të audituara, pagesat e rregullta të taksave etj.) dhe të kenë qëllim dhe vizion të qartë se ku dëshirojnë të dërgojnë kompaninë e tyre. Kjo do t'ju ndihmojë bankave të verifikojnë se a janë kompanitë duke u zhvilluar sipas planit të biznesit dhe si rezultat bankat do të jenë në gjendje të zvogëlojnë kostot operative dhe do të mund të zbresin normat e interesit. Sa i përket përqendrimit të tregut (në Kosovë rreth 74 % e tregut kontrollohet nga tri banka), shumica e bankave pohojnë se konkurrenca në sektorin bankar është e ulët por ato gjithashtu cekin se në mënyrë që të tërheqin banka të reja në treg shumë tregues negativ si korrupsioni, ekonomia joformale, problemet me implementimin e ligjit dhe gjyqësorit jo-efektiv (duke përfshirë problemet me fuqizimin dhe implementimin e

vendimeve të gjykatës) duhet të luftohen, sepse çdo bankë e re që hyn në ekonominë tonë do të ballafaqohet me këto probleme.

4.2 Financimi i NVM-ve në Kosovë – Rezultatet dhe Analiza e Anketës

Në mënyrë që të sigurojmë rezultate të besueshme me 95 % nivel të besimit dhe 5 % interval të besimit, është përzgjedhur një mostër prej 600 bizneseve në Kosovë duke u bazuar në bazën e të dhënave të marra nga ATK-ja e cila përmban rreth 57,000 biznese të regjistruara. Baza e të dhënave përmban të gjitha bizneset e regjistruara në Kosovë të renditura në bazë të sektorit dhe regjioneve të Kosovës (gjashtë regjione). Kjo është një metodë standarde e cila gjeneron rezultate përfaqësuese.

Pyetësori është përpiluar nga ekspertët e Institutit Riinvest. Anketa me NVM-të është kryer gjatë nëntorit dhe dhjetorit të vitit të kaluar. Intervistat me bizneset e përzgjedhura janë kryer në takime me përfaqësuesit e bizneseve nga një grup i zgjedhur i anketuesve të cilët janë trajnuar nga koordinatori i anketës në Riinvest. Qëllimi kryesor i anketës ka qenë të vlerësojë perceptimet dhe vlerësimet e NVM-ve sa i përket qasjes në financa në Kosovë. Gjithashtu, pyetësori është dizajnuar të vlerësojë barrierat kryesore për aktivitetet biznesore dhe për investime me të cilat NVM-ët ballafaqohen. Futja e të dhënave është kryer nga hulumtuesit e zyrës së statistikave në Institutin Riinvest, kurse përpunimi i të dhënave është kryer po të njëjtit hulumtues duke përdorur programin Excel dhe SPSS. Përmes këtyre programeve, rezultate të ndryshme statistikore janë gjeneruar të cilat janë përfshirë në raportin final.

Në vazhdim prezantojmë rezultatet e anketës. Siç edhe është pritur, pjesa më e madhe e firmave pjesëmarrëse në anketë kanë qenë mikro-ndërmarrje me 2-10 punëtorë. Anketuesit kanë përjashtuar të gjitha firmat të cilat kanë pasur 1 punëtor. Rreth 8 % e të anketuarve kanë qenë kompani të vogla, kurse vetëm 1.4 % kanë qenë kompani të mesme. Këto shifra janë në pajtim me strukturën e përgjithshme të firmave të regjistruara në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë; duke siguruar në këtë mënyrë implementimin e duhur të mostrës së anketës. Përveç treguesve të përmendur, 95.6% e firmave të anketuara që nga themelimi kanë qenë private, 3.5% kanë qenë të privatizuara (më parë ndërmarrje shoqërore) dhe 0.8% kanë qenë nën kategorinë "Tjetër". Në fund, rreth 92% e firmave janë vendore, kurse 8% kanë pronar të huaj.

Pavarësisht faktit që numri i bizneseve që operojnë në Kosovë është në ngritje, sfidë e rëndësishme për bizneset, posaçërisht për ato të Vogla dhe të Mesme, janë procedurat për të hapur një biznes. Kosova rangohet e 117-ta nga 183 vende për lehtësinë e të bërit biznes nga Banka Botërore (BB, 2011)

Pyetjet nga pyetësori dhe intervistat me ndërmarrës dhe menaxherë mbi barrierat e të bërit biznes dhe zgjidhjet e mundshme kanë qenë pjesë e rëndësishme e studimit. Rezultatet në Figurën 8 paraqesin perceptime të përgjithshme të 600 bizneseve mbi barrierat kritike të cilat pengojnë zhvillimin e sektorit privat në Kosovë.

Fig. 8 Barrierat e Bizneseve në Kosovë 2011



Burimi: UNDP HDR (2011)

Burimet e financimit paraqesin një faktor të rëndësishëm për zhvillimin e ndërmarrjeve në Kosovë të cilat si pasojë do të ndikonin në zhvillimin ekonomik të vendit. Por, mundësitë për financim nuk janë duke e lehtësuar krijimin e bizneseve të reja apo ngritjen e kapaciteteve të ndërmarrjeve në Kosovë. Ky pohim është nxjerrë nga fakti që normat e interesit nga bankat komerciale, te cilat janë burimet kryesore të jashtme të financimit, kualifikohen si të larta dhe si mbingarkesë për likuiditetin e ndërmarrjeve në përgjithësi. Anketa e NVM-ve me 600 kompani Kosovare thekson se kostoja e financimit dhe qasja në financa kanë pozita të rangut të mesëm ku e para ka 58 pikë kurse e dyta 56.6 (Figura8). Këta dy tregues nxjerrin në pah vështirësitë me të cilat NVM-të ballafaqohen gjatë ngritjes së kapitalit për zhvillim, duke i shtyrë ato të marrin kredi biznesore me norma të larta të interesit, duke i reduktuar potencialet e tyre për zhvillim apo në rastin më të keq, NVM-të mund të vendosin të heqin dorë nga projektet investuese për shkak të normave te papërballueshme të interesit në kredi. Duke u bazuar në Figurën 8, ne shohim se shumica e barrierave janë institucionale, dhe si rezultat i tyre, qeveria jonë është e paaftë të sigurojë një mjedis të sigurtë dhe

mbrojtës për investitorët e huaj potencial, prandaj ne ballafaqohemi me mungesë të investimeve të huaja.

Sa i përket normave të interesit, gjatë vitit 2011 norma mesatare e interesit në Kosovë ka qenë 14.3 %, ndërsa normat në vendet rajonale kanë qenë më të ulëta (Shqipëria-12.9%, Maqedonia-11.9%, Serbia-10.3%, Kroacia-10.2%). Gjithashtu, gjatë vitit 2010 Kosova ka pasur një normë mesatare të interesit prej 14.3%. Nëse analizojmë segmentet e tregut të kredive, bizneset janë ato të cilat kanë barrën më të madhe të normave të interesit sepse normat e interesit në kredi për biznese në mesatare kanë qenë 16.4% kurse për familje normat kanë qenë 14.3%. Këto norma të larta të interesit vazhdojnë të rëndojnë mjedisin biznesorë në vendin tonë. Dëshmitë nga anketa jonë sugjerojnë se posaçërisht firmat e vogla janë të dëmtuara nga qasja e dobët në kredi, gjë që ndikon në limitimin e perspektivave për rritje. ***Përmirësimi i qasjes në financim, posaçërisht për bizneset e vogla duhet të jetë prioritet në Kosovë.***

Anketa gjithashtu është fokusuar në planet e bizneseve për të filluar aktivitete të reja. Ky fokus na mundëson të kuptojmë kufizimet me të cilat bizneset ekzistuese ballafaqohen gjatë zgjerimit të aktiviteteve të tyre. Barrierat në këtë aspekt mund të jenë të ndryshme nga barrierat e gjetura në mjedisin e përgjithshëm biznesor. Në pyetjen nëse bizneset kanë planifikuar të fillojnë aktivitete të reja por nuk kanë mundur t'i fillojnë, Figura 9 tregon se shumica e bizneseve kanë nënvizuar koston e financimit si barrierën kryesore për zgjerimin e aktiviteteve të tyre, pasuar nga pasiguria në mjedisin e përgjithshëm të biznesit në të cilin operojnë këto firma. Për dallim nga barrierat e përgjithshme të prezantuara në Figurën 8, këtu kategoria e financimit është paraqitur si barrierë kryesore për zgjerim, duke e potencuar edhe një herë faktin që qasja në financim ka penguar zgjerimin e aktiviteteve të NVM-ve.

Fig. 9 Barrierat për aktivitetet e reja biznesore



Burimi: UNDP HDR (2011)

Qasja në financa dhe kostoja e financimit përsëri paraqiten si barriera kryesore në mjedisin biznesor. Së pari, është e kuptueshme që bizneset në Kosovë janë duke operuar në kufijtë e përfitimit të tyre, pa pasur shumë opsione (pra fonde të brendshme) për zgjerim. Së dyti, duket interesante që konkurrenca jo-fer (këtu e përfshirë pjesërisht në pjesën e mjedisit të pasigurt biznesor) e cila paraqitet si barrierë kryesore në aktivitetet e përgjithshme biznesore është më pak e rëndësishme kur i njehsojmë përgjigjet e firmave gjatë planifikimit të aktiviteteve të reja.
Zhvillimi i fuqishëm i sektorit të NVM-ve është shumë i rëndësishëm për krijimin

e vendeve të reja të punës dhe uljen e varfërisë në Kosovë. NVM-të në Kosovë, posaçërisht në sektorin e prodhimtarisë, mbesin të brishta dhe jo-konkurruese. Niveli i dobët i infrastrukturës (posaçërisht energjisë), niveli i lartë i korrupsionit, mungesa e financave, paqëndrueshmëria politike, dhe funksionimi i dobët i gjyqësorit kanë kontribuar në një mjedis biznesor me performancë jo të mirë. Si rezultat i këtyre faktorëve, kontributi i NVM-ve në ekonomi ka qenë i pamjaftueshëm. ***Nga gjithë kjo kuptohet që qasja në financa dhe kostoja e financimit janë barrierat kryesore për zhvillimin e qëndrueshëm të bizneseve.***

Sipas anketës të kryer nga Instituti Riinvest, marrja e huave nga NVM-të tek bankat është në nivel shumë të ulët, duke llogaritur se vetëm 12% e firmave kanë kredi. Huamarrja e NVM-ve nga familjarët apo miqtë është 10%, ndryshim shumë i vogël nga huamarrja prej bankave. Sidoqoftë, shumica e firmave (74% e firmave) në Kosovë tentojnë të mbështeten në fitimet e pashpërndara dhe fondet vetanake për financimin e ndërmarrjeve të tyre. Siç është cekur edhe më parë, Figura 9 tregon që qasja në financa dhe kostoja e financimit mbeten ndër top barrierat në Kosovë dhe fakti që 73 % e firmave në Kosovë nuk kanë marrë kredi në vitin 2010 tregon masën e problemeve me të cilat ballafaqohen bizneset gjatë marrjes së kredisë. Kufizimi për financim duket që varet nga madhësia e firmës. Rreth 87 % e firmave që kanë raportuar qasje pozitive në financa (që do të thotë se këto firma kanë marrë kredi në 2010) janë mikro-firma, krahasuar me rreth 11% të cilat janë firma të vogla dhe rreth 2.5% të cilat janë firma të mesme. Duke pasur parasysh faktin që 96% e NVM-ve janë mikro-firma, një lidhje pozitive mund të vërehet në mes të madhësisë së firmës dhe qasjes në financa. Edhe pse sistemi bankar në Kosovë është duke përparuar vazhdimisht, vetëm një numër i vogël i firmave i kryejnë transaksionet e tyre biznesore përmes bankës[11]. Nga të gjitha kompanitë e anketuara, rreth 44% e tyre i procesojnë shitjet e tyre përmes bankës.

Si rezultat, ndërgjegjësimi më i madh i ndërmarrësve lidhur me rëndësinë e përmirësimit të raportimit financiar është shume i rëndësishëm pasi që fakti që një raportim më i mirë financiar do të ndikonte në rritjen e besimit të bankave ndaj bizneseve. Me raportim financiar më të mirë, bankat do të ndihmojnë dhe lehtësojnë qasjen e NVM-ve në financa dhe do të zbrisnin koston e financimit.

Rezultatet e anketës gjithashtu tregojnë që shumica (68 %) e firmave jo-përfituese nuk kanë aplikuar për financim dhe se vetëm 5% e NVM-ve të anketuara të cilat nuk kanë marrë kredi kanë aplikuar për kredi. Figura 10 tregon që pothuajse gjysma e të anketuarve kanë cekur normat e larta të interesit në kredi si arsye kryesore për të mos aplikuar për kredi, përderisa 40% nuk kanë pasur nevojë për kredi. ***Arsyet kryesore për të mos aplikuar për kredi të cekura nga NVM-të janë: normat e larta të interesit, nuk kanë pasur nevojë për kredi, mosbesimi se do të mund të marrin kredi nga banka dhe kolateral i pamjaftueshëm (shiko Figurën 10).***

11 Me qarkullimin e shitjeve përmes bankës ne nënkuptojmë hapjen e llogarive bankare, deponimin e të hollave në fund të ditës në bankë dhe instalimi i makinave POS në shitoret e tyre.

Figure 10 – Arsyet për të mos aplikuar për kredi



Burimi: UNDP HDR (2011)

Sa i përket planeve për investime nga firmat (aktivitete e reja biznesore), shumica e firmave (80%) kanë cekur se nuk planifikojnë të zgjerojnë aktivitetet e tyre apo të fillojnë aktivitete të reja biznesore, kurse 20 % e firmave kanë cekur se do të fillojnë aktivitete të reja biznesore. Sidoqoftë, rezultatet nga anketa kanë gjetur që të gjitha firmat që kanë marre kredi nga bankat në vitin 2011 (rreth 35% e tyre) planifikojnë të fillojnë aktivitete të reja biznesore, përsëri duke paraqitur lidhjen pozitive në mes të qasjes në financa dhe investimeve.

Figure 11 – Perceptimet e firmave lidhur me kushtet e financimit në Kosovë



Burimi: UNDP HDR (2011)

Figura 11 tregon që perceptimet e firmave lidhur me kushtet e financimit në Kosovë dallojnë lehtësisht pasi që shumica e firmave (rreth 70%) konsiderojnë që kushtet e financimit nuk janë të favorshme, në fakt janë të pafavorshme për bizneset, kurse 30% e firmave besojnë që kushtet e financimit janë të favorshme. Kurse perceptimi i bankave lidhur me normat e interesit në Kosovë për NVM-të është se normat nuk janë të larta fare dhe se ato pasqyrojnë mjedisin biznesor në Kosovë. Sipas rezultateve të anketës, asnjë biznes nga sektori primar nuk mendon se kushtet e financimit janë të favorshme dhe se vetëm një numër i vogël i firmave në sektorin dytësor mendojnë se kushtet e financimit janë të favorshme. Në përgjithësi, portofoli i kredive në sektorin

bankar të Kosovës vazhdon të ketë kualitetin e mirë. Pavarësisht nga niveli i ulët i kredive jo-performuese, në krahasim me vendet e rajonit, normat e interesit të kredive vazhdojnë të jetë më të lartat në rajon. Përfaqësuesit nga sektori bankar argumentojnë se mjedisi i papërshtatshëm biznesor është arsyeja kryesore për burokracinë e tyre dhe se niveli i ulët i kredive jo-performuese vjen si rezultat i konservatizmit të tyre në aprovimin e kredive.

Konsensusi i përgjithshëm është që mjedisi i papërshtatshëm biznesor është arsyeja kryesore e normave jo te ulëta të interesit; por përveç kësaj firmat vet bartin një pjesë të përgjegjësisë. Evazioni fiskal dhe informaliteti ju pamundëson bizneseve të përgatisin dhe të ofrojnë raporte financiare bindëse. Gjithashtu, pamundësia për të parashikuar performacën e firmave është duke kontribuar tek rreziku i lartë kreditor, i cila pastaj rezulton në konservatizëm më të lartë nga bankat (qasje te ulët në financa)

Kolaterali kufizon kompanitë për të aplikuar për kredi pasi që bankat komerciale kërkojnë që çdo kredi mbi 10,000 euro duhet te kolateralizohet me tokë apo ndërtesë dhe gjithashtu edhe kreditë më të vogla zakonisht kërkojnë ndonjë formë të kolateralit. Gjithashtu, jo të gjitha format e kolateralit pranohen njëjtë nga të gjitha bankat dhe preferencat e tyre vendosen nga kostot e tanishme dhe të parashikuara në krijimin dhe zbatimin e të drejtave pronësore, likuiditeti dhe pozita drejt kreditorëve tjerë në rast të pamundësisë për të paguar kredinë. Këto preferenca për kolateral të cilat bazohen në "çështjet administrative" si shtesë mbi rregulloret e BQK-së janë duke limituar qasjen në kredi të NVM-ve. Kreditë për NVM-të shpesh garantohen me pasuri të patundshme si depo dhe zyrat e kompanisë apo shtëpia e pronarit. Prandaj financimi i hipotekës është normalisht një pjesë shumë e rëndësishme e financimit të NVM-ve. Të gjitha kreditë të cilat aprovohen në Kosovë kërkojnë një garantues. Raporti kolateral kredi, përkatësisht raporti i mbulimit të kredisë me kolateral në Kosovë në vitin 2010 ka qenë 236.1%. Ky raport është më i larti në rajon (raporti mesatar në rajon ka qenë 126.6%). Ky fakt edhe më shumë i forcon nevojat e tmerrshme të NVM-ve për financimin e investimeve të tyre dhe nivelin e varësisë së NVM-ve në kreditë bankare.

4.3 Komisioni Kosovar i Konkurrencës & Aleanca Kosovare e Bizneseve- Rezultatet dhe Analiza nga intervistat

Komisioni Kosovar i Konkurrencës (KKK) dhe Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) e vlerësojnë sistemin bankar si shumë të shëndetshëm, me numrin më të ulët të KJP-ve dhe profitin më të lartë krahasuar me vendet e rajonit. Sipas KKK dhe AKB, arsyeja se pse Kosova ka koncentrimin më të lartë të tregut se vendet e rajonit është se një numër më i vogël i bankave operojnë në Kosovë se në vendet e rajonit. Përvoja nga vitet e fundit tregon se me hyrjen e bankave të reja në treg, koncentrimin i tregut është zvogëluar, por KKK dhe AKB mendojnë se BQK dhe qeveria jonë duhet të bëjnë më shumë për të përmirësuar mjedisin biznesor dhe për të adresuar barrierat dhe problemet e shumta me të cilat ballafaqohen bankat komerciale. Një mënyrë për t'i shtyrë bankat për t'i ulur normat e interesit është përmes licencimit të bankave tjera, pra rritjes së konkurrencës.

Sa i përket krahasimit të sistemit bankar me rajonin, është vështir të bëhet një krahasim pasi që të gjitha vendet fqinje kanë monedhën e tyre që ju mundëson të kenë politik monetare efektive, kurse Kosova nuk ka monedhë të vetën dhe është e limituar në aspektin e politikës monetare. Gjithashtu KKK mendon se një arsye se pse normat e interesit në kredi janë të larta vjen nga mospërputhja në mes të maturisë së depozitave dhe maturisë së kredive. Sipas KKK dhe BQK, depozitat kohore janë afat-shkurtra (më pak se dy vite), kurse kreditë aprovohen për një kohë më të gjatë (mesatare 5 vite), që nënkupton se bankat duhet të mbajnë rezerva shtesë në mënyrë që të mbulojnë tërheqjet e depozitave dhe si rezultat kostoja e financimit për bankat rritet. Gjithashtu, KKK dhe AKB mendojnë se barrierat e cekura më lartë nga bankat janë disi të ekzagjeruara dhe se nga këndvështrimi i tyre bankat kanë krijuar një pozitë shumë të rehatshme në treg dhe nuk dëshirojnë të ndryshojnë.

4.4 Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (Trusti)

Duke pasur parasysh faktin se shumica e investimeve të Trustit janë orientuar kah tregu ndërkombëtar, dhe me planet e reja të Qeverisë për të emetuar letra me vlerë, Trusti potencialisht do të mund të drejtonte një pjesë të investimeve në këto letra me vlerë, duke siguruar në këtë mënyrë një kthim më të qëndrueshëm në fitim prej 3.51% duke krahasuar me kthimin e paparashikueshëm i cili vjen nga bursat e tanishme ndërkombëtare të cilat janë të paqëndrueshme dhe të luhatshme. Investimi nga Trusti do t'i mundësonte Qeverisë mbështetjen e projekteve të cilat orientohen drejt zhvillimit ekonomik dhe indirekt të kontribuoj në zvogëlimin e normave të interesit në kredi.

5. ANALIZAT KRAHASUESE NDËR-SHTETËRORE

5.1 Përcaktuesit e normave të interesit të kredive dhe depozitave, vështrim dhe analizë krahasuese për Rajonin e Ballkanit

Politika e normave të interesit është një ndër instrumentet më të rëndësishëm të politikës monetare. Eksperienca e përbashkët, si në vendet e zhvilluara, ashtu edhe në ato në zhvillim ka dëshmuar se politika optimale e normave të interesit është një parakusht thelbësor në orientimin e duhur për zhvillimin ekonomik të vendit. Nga studimet e literatura e grumbulluar për të gjitha vendet e Evropës Juglindore (EJL), përfshirë dhe Kosovën rezulton se niveli i normave të interesit përcaktohet nga tregu. Përgjithësisht ky rajon vlerësohet nga ekspertët të ketë norma (nominale e reale) relativisht të larta të interesit për kredinë, të cilat përkthehen për rrjedhojë dhe në shpërdarje (spread) të larta nga interesat.

Analiza e Spread-it të normave të Interesit – Shpërndarja (Spread) i normave të interesit të kredive dhe atyre të depozitave konsiderohet si një tregues i efiçencës së ndërmjetësimit financiar. Ky tregues del si diferencë e interesit ex-post të huave me interesin implicit të depozitave. Për një periudhë kohore të caktuar, p.sh. 6-mujore, ky variabël llogaritet duke marrë totalin e të ardhurave të interesit të fituara nga kreditë e dhëna për periudhën pjesëtuar me nivelin mesatar të huave për të njëjtën periudhë dhe duke zbritur totalin e shpenzimeve për interesa nga depozitat e periudhës në fjalë pjesëtuar me mesataren e depozitave bankare për të njëjtën periudhë kohore. Përqindjet e larta të shpërndarjes (spread) të interesit janë një pengesë për ndërmjetësimin financiar, pasi ato i dekurajojnë kursimtarët potencialë me kthime të ulëta nga depozitat, ndërkohë që rrisin koston e financimit për huamarrësit (individë dhe kryesisht biznese), duke pakësuar mundësitë për investime dhe rritje ekonomike. Kjo është veçanërisht shqetësuese për ekonomitë në tranzicion ku mundësitë për burime financimi alternative përmes tregut të kapitalit janë thuajse minimale ose jo-ekzistente në rastin e Kosovës apo Shqipërisë dhe një sërë vendesh të tjera të rajonit të Evropës Juglindore (EJL), duke i lënë këto vende tërësisht nën "mëshirën" e sistemit bankar që është mbizotërues në sistemin financiar të EJL-së.

Bazuar në gjetjet e Stiglitz dhe Weiss, 1981, shpërndarjet (spread) e larta të interesit vijnë si rezultat i inefiçiencave bankare të tregut, të tilla si kostot e larta të transaksionit dhe informacioni asimetrik. Kostot e ndërmjetësimit që lidhen me përzgjedhjen, analizën dhe monitorimin e huamarrësve, me shërbimet e depozitave dhe të pagesave si dhe asimetritë e informacionit që gjenerojnë kostot e agjencisë, krijojnë një pengesë/bllokim ndërmjet normave të interesit që u paguhen kursimtarëve nga njëra anë dhe normave të interesit që u ngarkohen huamarrësve. Sa më të mëdha të jenë këto inefiçienca bankare aq më të larta do jenë shpërndarjet (spread) e interesit të bankave, duke ulur përfitimet dhe kërkesën për ndërmjetësim financiar.

Diferencat në shpërndarje (spread) - Përpara se të fillojë hedhjen e produkteve të reja, çdo bankë analizon me shumë prioritet këto tregues të mëposhtëm:

- Raporti i likuiditetit
- Qëllimi i biznesit (nëse banka ka si qëllim të jetë e para në treg, atëherë ajo mban normat më të mira në treg, pavarësisht nga shpërndarja - spread).
- Konkurrenca, për të parë nivelin e normave të interesit të bankave të tjera, në mënyrë që banka të jetë konkurruese.
- Rrezikun e vendit dhe rrezikun e klientit, për të përcaktuar rrezikun e kredisë.
- Rreziqe më të mëdha përkthehen në shpërndarje (spread) më të larta.
- Lloji i kolateralit, ndikon direkt në spread-in e produktit. Sa më i mirë kolaterali, nga pikëpamja e cilësisë së tij, aq më të ulëta do të jenë normat e shpërndarjes (spread-it).
- Kostot e tjera të përfshira (shpenzimet e marketingut, shpenzimet e tjera të përfshira për transaksionet).
- Niveli i kredive me probleme (NPL) në sistemin bankar të vendit

Sipas burimeve të shumta të literaturës në këtë fushë (Demirgüç-Kunt and Huizinga, 1999; Dell'Arriccia and Márquez, 2004) ekzistojnë një sërë faktorësh që ndikojnë në koston e ndërmjetësimit bankar të një vendi. Kështu, shkak për nivelin e lartë të shpërndarjes (spread) mund të jenë një sërë faktorësh të mjedisit ekonomik, financiar e ligjor të tregut, duke filluar nga:

a) niveli i ulët i kursimeve në vendet përkatëse, ndërkohë që kërkesa për kredi paraqitet e lartë dhe me tendencë rritëse,
b) burimet e kufizuara dhe me kosto relativisht të lartë të financimit,
c) akses i kufizuar në tregjet financiare dhe ato të tregut të parasë ndërkombëtare,
d) struktura e tregut (pronësia e bankave, niveli i përqendrimit bankar, shkalla e konkurrencës etj.),
e) ekzistenca e një primi të lartë rreziku për secilin vend, sidomos për mungesë të disiplinës financiare dhe problemeve me ekzekutimin ligjor të pretendimeve të bankave ndaj klientëve të tyre lidhur me kreditë e pashlyera (problem me njohjen, regjistrimin dhe ekzekutimin e shitjen e garancive hipotekare),
f) kostove relativisht të larta operative të bankave,
g) niveli i lartë i NPL-ve në rajon,
h) niveli i lartë i informalitetit dhe pasaktësia/manovrimet me pasqyrat financiare të bizneseve etj.

Përveç faktorëve të cekur më lartë, është vërtetuar që shpërndarjet (spread) ndikohen edhe nga faktorët tjerë specifikë të një banke siç janë aftësitë menaxheriale, kostot operative të vetë bankës, aftësitë e analizës dhe menaxhimit të riskut, të menaxhimit të likuiditetit dhe portofolit të investimeve, niveli i mjaftueshmërisë së kapitalit etj.

Studime të shumta (Beck and Hesse, 2006) kanë vërtetuar ekzistencën e një marrëdhënie negative ndërmjet madhësisë së një banke dhe kostove operative, si dhe mad-

hësisë së bankës dhe shpërndarjes (spread) të interesit. Kjo vjen kryesisht për faktin që kostot e ndërmjetësimit përbëjnë një komponent fiks për kostot e sistemit bankar e financiar. Në kushtet e ekonomive të shkallës, pra në rastin e bankave të mëdha, të cilat janë të afta të veprojnë në tregje me një numër të madh dhe të diversifikuar klientësh, këto kosto bëjnë diferencën duke ndikuar në uljen e spread-it nga interesat. Por në vende të vogla, me tregje relativisht të kufizuara dhe për banka jo të mëdha, dështimet e tregut si paaftësia për diversifikimin e kredimarrësve, zgjedhja e keqe etj.

kushtëzojnë një premium më të lartë të riskut për normat e interesit të kredisë. Konkretisht, në shumicën e vendeve të rajonit të Ballkanit, shpërndarjet (spread) e larta justifikohen me ekonomitë e parealizuara të shkallës, për shkak të madhësisë së limituar të tregut dhe nivelit relativisht të ulët të konkurrencës në tregun bankar dhe atë financiar në tërësi.

Nga analiza sistematike e rezultateve financiare të sistemit bankar në përgjithësi vërehet se bankat me një nivel relativisht më të lartë të aktiveve që sjellin të ardhura jo nga interesat, janë më pak fitimprurëse. Gjithashtu, bankat që mbështeten kryesisht në depozitat e klientëve si burime për financimin e aktivitetit të tyre janë më pak fitimprurëse, sepse depozitat kërkojnë edhe shpenzimet e tjera, ndërkohë që kostot e fondeve të tyre janë më të larta se huatë apo financimet e tjera afatshkurtër apo në tregun monetar.

Faktorë të tjerë që shpjegojnë nivelet e larta të shpërndarjeve (spread) sidomos ne Shqipëri, Serbi, Maqedoni janë edhe apetiti i ulët nga bankat tregtare për të marrë përsipër risqe, sidomos kur tregu lokal ofron investime me kthime interesi mjaft atraktive në letrat me vlerë të qeverisë në monedhën lokale. Një faktor tjetër që ndikon në mbajtjen e shpërndarjeve (spread) të larta është dhe shkalla akoma e ulët e ndërmjetësimit bankar në rajon në krahasim me ekonomitë e zhvilluara evropiane, e cila matet përmes treguesit të raportit të huave ndaj GDP-së. Ky tregues, sidomos për Kosovën është nën 40%.

Karakteristikë e përbashkët e sistemit bankar të gjithë vendeve të Europës Juglindore dhe atyre të rajonit të Ballkanit është një prezencë në rritje gjatë 15 viteve të fundit të bankave të huaja. I tillë është rasti i Maqedonisë (93%), Bosnje Hercegovinës (92%), Shqipërisë (92%), Kroacisë (90.4%), Kosovës (90.2%), Malit të Zi (88%), Serbisë (74%). Hyrja në treg e bankave të huaja me produkte të reja, me më shumë përvojë në tregun e kredidhënies dhe analizës së riskut të kredisë dhe me mbështetje fondesh nga bankat mëmë për financimin e bankave bija apo filialeve të hapura në këto vende u shoqërua me bum të aktivitetit të kreditimit, sidomos në aspektin e kredisë për individët ose ndryshe e quajtur kredia konsumatore, përfshirë këtu edhe kredinë për SME-të. Rritja e kredisë u stimulua gjerësisht nga shpërndarjet (spread) 2-3 herë më të larta që realizonin këto banka në Ballkan në raport me vendet e BE-15 apo vende të tjera të industrializuara. Kështu, nivelet e kreditimit ndaj GDP-së në shumicën e këtyre shteteve para futjes së partnerëve të huaj në tregun bankar ishin diku rreth 20-25% të PBB-së, ndërsa në 2009, këto nivele ishin mbi 60% e PBB-së. Ky bum kontribuoi në zhvillimin ekonomike të këtyre vendeve, duke krijuar një model rritjeje të bazuar në mbingarkesën në rritje të huave personale si në shtimin e detyrimeve bankare nga sektori privat. Përhapja e krizës financiare në Evropë gjatë vitit 2009-2010 solli një përkeqësim të nivelit të kredive të këqija në mjaft shtete të rajonit, sidomos në vendet ku kreditimi në monedhë të huaj (Euro) zinte peshën kryesore të

kreditimit, gjë që çoi më pas në ngadalësimin e ritmeve të kredisë.

Gjithashtu një arsye më shumë për rritjen e normave të interesit të kredive është edhe perceptimi i lartë i riskut në këto vende nga bankat e huaja, të cilat shpesh mbështeten në analizat apo modelet statistikore të vlerësimit të riskut të kredisë dhe jo në kontaktet direkte me kërkuesit e huave. Këto modele, në kushtet e një ekonomie informale, ku bizneset shpesh punojnë me dy lloje bilancesh imponojnë caktimin e një premiumi më të lartë të riskut në raport me tregjet e zhvilluara financiare perëndimore. Një ndikim të konsiderueshëm në nivelin e lartë të interesave të kredive në rajon jep edhe mbështetja e pakët e bankave tregtare tek të ardhurat nga jo-interesat, e cila lidhet me miksin e produkteve e shërbimeve bankare të ofruara nga bankat e rajonit. Në kushtet kur ndërmarrjet e mëdha sigurojnë financime në treg, qoftë edhe në rrugë private, sektori bankar në vendet e EJL-së mbështetet kryesisht në kredinë individuale si burim fitimi, ndërkohë që bankat e këtyre vendeve nuk ofrojnë shërbime të bankingut investues apo shërbime të tjera financiare si planet e pensioneve, të sigurimit, të investimeve etj., të cilat sigurojnë komisione të larta nga jo-interesat. Zakonisht, sa më të larta të jenë të ardhurat nga jo-interesat në strukturën e të ardhurave të një banke, aq më shumë mundësi për kompensim të kryqëzuar të të ardhurave ka banka dhe për pasojë aq më shumë mundësi për uljen e nivelit të spread-it nga interesat. Në të tilla kushte, të ardhurat nga interesat dhe shpërndarjet (spreade) e larta mbeten burimi kryesor i të ardhurave të bankave.

Në vazhdim, është vënë re që një përqendrim i lartë bankar (i matur përmes index-it Herfindahl-Hirshman (HHI) – 2,157 pikë si në tregjet e depozitave, ashtu edhe në tregun e huasë, ka lidhje të konsiderueshme pozitive me shpërndarjet (spread) e interesit. Pra, sa më e lartë shkalla e përqëndrimit bankar në treg, aq më i lartë shpërndarja (spread). Në tregun rajonal të Ballkanit, përqendrimi i tre bankave më të mëdha varion nga 54% të tregut në Kroaci (minimali), në 66% në BiH (maksimumi), si dhe në 74 % të tregut në Kosovë duke diktuar nivele të larta të shpërndarjes (spread) nga interesat.

Ajo që vihet re rëndom në bankat e gjithë rajonit, përfshirë dhe Kosovën, janë nivelet e larta të raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit (kapitali rregullator i shprehur si raport i aktiveve të peshuara me riskun). Ky tregues ishte në nivelin e mbi 16.6% për gjithë vendet e Ballkanit në fund të vitit 2010, përsëri i lartë madje edhe pas periudhës së krizës së viteve 2008-2009, kur si rrjedhojë e fitimeve në rënie dhe rritjes së provigjionimit të kredive me probleme, treguesi pësoi rënie të dukshme. Me këto nivele kapitali këto banka vërtet kanë mundësi më të mëdha të përballojnë goditjet e papritura të tregut, ose në raste krizash, por nga ana tjetër ato humbasin përfitimet që siguron një levë e lartë financiare, e cila amplifikon në kohëra të mira fitimet dhe kthimet e larta të kapitalit të vet (ROE). Kjo bën që shumë banka në rajon të vazhdojnë të mbështeten fuqishëm në strategjinë e një shpërndarje (spread) të lartë, duke mbajtur artificialisht të larta normat e interesit të kredive. Bankat me shpenzime më të larta administrative, zakonisht ato që janë të fokusuara në veprimtarinë e retail-it (pra që kanë më shumë klientë të SME-ve dhe depozitues të vegjël, me teprica të ulëta mesatare kredie dhe depozite për klient), siç është rasti i bankave në rajonin e Ballkanit, ka më shumë gjasa të rrisin shpërndarjet (spread) nga interesi për të kompensuar kostot e larta administrative.

Sipas një studimi të FMN-së (E. Dabla-Norris & H. Floerkemeir, 2007) mbi efiçiencën bankare dhe strukturën e tregut dëshmohet se "bankat e mëdha dhe më shumë likuide, që kanë një shkallë më të ulët ekspozimi ndaj huave konsumatore dhe atyre në sektorin e bujqësisë shoqërohen më nivele më të ulëta të shpërndarjes (spread). Bankat dominuese në treg, me një nivel të lartë të pjesës së tregut, gëzojnë gjithashtu shpërndarje (spread) më të larta. Këto banka pavarësisht nga ekonomitë e shkallës, nëse bëhen mbizotëruese në treg, arrijnë të diktojnë norma të larta interesi për aktivet e tyre, konkretisht kreditë, për shkak të fuqisë mbizotëruese në treg. Po kështu bankat me nivele më të larta likuiditeti, siç është rasti i bankave të rajonit tonë, kanë më pak aktive me risk dhe për pasojë sigurojnë fitime më të ulëta në raport me bankat që kanë një portofol të konsiderueshëm të aktiveve të tyre në formë huash.

Në rastin kur tregu i depozitave është konkurrues, e vetmja mënyrë që këto banka të mbajnë nivele të larta fitimi është përmes aplikimit të niveleve të larta të interesave për kreditë që ato ofrojnë dhe për pasojë edhe të shpërndarjeve (spread) të larta. Jo më pak rëndësi paraqet për nivelet e interesave të kredive edhe struktura e portofolit të kredive të një banke sipas sektorëve të ekonomisë, duke reflektuar premiumin për riskun e sektorit përkatës. Bankat me përqendrim të lartë të kredive në sektorin e prodhimit/përpunimit dhe atë tregtar, zakonisht për shkak të nivelit të ulët të riskut të perceptuar dhe kolateralit relativisht të lehtë për të siguruar dhe ekzekutuar, kanë norma më të ulëta interesi se ato që investojnë në sektorin bujqësor, ku pasiguria është shumë më e madhe apo ato që merren kryesisht me kredinë konsumatore. Sipas studimit të FMN-së për efiçiencën bankare, bankat me 10% më shumë ekspozim të huave në fushën e bujqësisë apo të kredisë konsumatore, aplikojnë nga 0.4 - 1.0 pikë bazë më shumë në shpërndarjet (spread) e tyre mesatare kundrejt bankave simotra.

Analiza e marzhit neto nga interesat dhe e faktorëve përcaktues të tij - Marzhi neto nga interesi është një tregues tjetër i eficencës së ndërmjetësimit financiar. Ai llogaritet si diferenca e të ardhurave nga interesat me shpenzimet e interesave pjesëtuar me mesataren e aktiveve totale të bankës. Për të caktuar primin shtesë që bankat vendosin mbi normat bazë të interesit, ato bazohen në strukturën e tregut bankar, qëndrimin e tyre ndaj rrezikut, luhatshmërinë e normave dhe madhësinë mesatare të transaksioneve bankare. Një ulje e marzhit neto nga interesat mund të shkaktohet nga një ulje e taksave apo nga një rritje në provigjionim. Nëse një masë e këtij marzhi interesash shpjegohet nga luhatshmëria e normave, atëherë politikat duhet të fokusohen në arritjen e një stabiliteti makroekonomik. Nëse ndikimi vjen nga fuqia e bankave në treg, atëherë fokusi duhet të jetë i orientuar drejt inkurajimit të rritjes së konkurrencës. Dallimet në marzhet e normave të interesit pasqyrojnë një shumëllojshmëri përcaktuesish:

- Karakteristikat e bankës
- Kushtet makroekonomike
- Tatimet dhe taksat
- Rregullorja mbi sigurimin e depozitave
- Strukturën e përgjithshme financiare
- Disa tregues të bazës ligjore dhe institucionale

Gjithashtu, bankat e huaja kanë prirje të kenë marzhe më të larta interesi në vendet në zhvillim si Shqipëria, Kosova, Mali i Zi, etj duke qenë se ato kanë avantazhe në teknologji kundrejt bankave vendase, por nga ana tjetër siç u sqarua edhe më lart, ato kanë një mungesë informacioni mbi tregun e vendit në të cilin operojnë, përfshirë rastin e vendeve të Evropës Juglindore. Madhësia e bankave tenton të ndikojë në marzhe më të ulëta si rezultat i ekonomive të shkallës, ndërkohë sa më të larta kostot operative, aq më të larta do të jenë marzhet e interesit, në mënyrë që këto kosto të mbulohen. Ndikim të drejtpërdrejtë në marzhin neto nga interesat ka edhe niveli i kredive me probleme. Sa më i lartë niveli i kredive me probleme, aq më i lartë rreziku i kredisë dhe si pasojë edhe marzhet e normës së interesit. Në këtë rast, bankës i duhet të mbulojë këto humbje të shkaktuara nga këto kredi, duke i transferuar kostot e saj tek klientët, në formën e normave më të larta të interesit për kredi. Në rastin konkret, kjo normë në rritje e kredive me probleme në vendet e rajonit tonë nuk e ndihmon aspak uljen e interesave për kredi, të paktën në afatin e shkurtër dhe të mesëm. Aktualisht, sipas BSCEE Review 2010, normat e NPL-ve për rajonin në fund të vitit 2010 varionin nga 9% (niveli më i ulët në Maqedoni), në 21% në Malin e Zi, ku mesatarja e NPLve për rajonin qëndronte në nivelin e 14%, por me tendencë në rritje në rreth 17% gjatë 6-mujorit të parë të 2011.

Një faktor tjetër përcaktues në madhësinë e marzhit neto të interesave është edhe niveli i rezervës së detyrueshme. Bankat janë të detyruara të vendosin depozitat e tyre në formën e rezervës së detyrueshme pranë Bankës Qendrore, dhe si pasojë, kostoja oportune e mbajtjes së këtyre rezervave duhet të kompensohet nga vendosja e normave më të larta të interesit për kredi. Rritja ekonomike e vendit është gjithashtu një faktor i domosdoshëm në nivelin e marzhit neto të interesave, duke qenë se aftësia paguese e kredimarrësve lidhet në mënyrë direkte me këtë faktor. Për shembull, në periudha recesioni, kjo aftësi paguese bie dhe si rezultat kredimarrësit mund të përfitojnë kredi pranë bankave, por me norma më të larta, të cilat rriten për të mbuluar këtë rënie në aftësinë paguese.

- Dallimet në aktivitetin bankar dhe në karakteristikat e secilës bankë kanë një ndikim në marzhet e interesave të bankave të ndryshme. Ndryshimi në shpenzimet operative dhe shpenzime të tjera nga njëra bankë në tjetrën reflektohet në ndryshime të marzheve të normave të interesit bankar, pasi bankat e kalojnë barrën e shpenzimeve të tyre operative tek kredimarrësit e tyre. Kjo vjen dhe për arsye të kostos më të ulët të fondeve të marra shpesh nga bankat mëmë dhe mbështetëse që krijon mëma në modelet e menaxhimit të riskut të kredisë, standardizimit të procedurave, ekonomive të shkallës etj.

- Pronësia ndërkombëtare e bankave ka gjithashtu një ndikim të rëndësishëm mbi marzhet bankare. Bankat e huaja, në veçanti, realizojnë marzhe më të larta të interesit se bankat vendase në vendet në zhvillim (duke përfshirë edhe Kosovën), dhe më të ulëta në vendet e zhvilluara.

- Faktorët makroekonomikë mund të shpjegojnë ndryshimin në marzhet e normave të interesit. Gjithashtu, inflacioni është i lidhur me marzhe më të larta të interesit të realizuara nga bankat, për shkak të kostove më të larta.

- Për sa i përket strukturës financiare të sistemit bankar të një vendi, bankat në

vende me një sektor bankar më konkurrues, ku ka një raport më të lartë të totalit të aktiveve të sektorit bankar ndaj PBB-së, kanë marzhe më të ulëta të interesit. Gjithashtu, ndikim në nivelin e marzheve të interesit ka dhe raporti i përqendrimit bankar, i cili ndikon pozitivisht në përfitueshmërinë e bankave. Kështu, banka më të mëdha dhe me pozita dominante në treg tentojnë të kenë marzhe më të larta në raport me vendet ku sistemi bankar është i shpërndarë mes bankave të ndryshme duke pasur një nivel të ulët përqendrimi.

- Së fundi, diferencat në çështjet ligjore dhe institucionale janë shumë të rëndësishme dhe kanë një ndikim të madh në përcaktimin e normave të interesit. Treguesit e zbatimit më të mirë të kontratave, efiçienca e sistemit ligjor dhe mungesa e korrupsionit janë të lidhura me marzhet më të ulëta të interesit të realizuara.

Treguesi i kredive me probleme për rajonin - Një tregues i rëndësishëm krahasues ndërmjet vendeve për sa i përket kredisë lidhet me burimet e financimit. Në fakt, për Shqipërinë, Maqedoninë, Malin e Zi (të paktën fillimisht) dhe Serbinë, zgjerimi i kredisë është financuar duke u mbështetur më shumë mbi depozitat në vend (pra në burimet lokale të financimit) se sa në linjat e kredisë (qoftë nga bankat mëmë apo edhe në tregun ndër-bankar me bankat rezidente dhe jo-rezidente). Ndërsa në Kosovë kreditë përbëhen kryesisht nga depozitat. Për sa i përket normave të kredive me probleme për vendet e rajonit (shiko tabelën 10), ato paraqesin një pamje disi të përzier, por sidoqoftë prirja e tyre mbetet rritëse për të gjitha këto shtete. Kjo normë jo pak e ulët, veçanërisht për disa prej tyre, paraqet kosto më të larta për bankat në formën e provigjioneve, rrezik më të lartë të marrë përsipër, përfitueshmëri më të ulët, prandaj si rezultat i të gjithë faktorëve të lartpërmendur edhe norma interesi më të larta për kreditë.

Tabela 10: Treguesi i kredive me probleme për rajonin

Raporti i kredive me probleme (në %)							
	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011
Shqipëria	2.3	3.1	3.4	6.6	10.5	13.9	17
Bosnje-Herzegovina	5.3	4.0	3.0	3.1	5.9	9.2	11
Kroacia	6.2	5.2	4.8	4.9	7.8	11.2	n.a
Maqedonia	15.0	11.2	7.5	6.7	8.9	9.75	9.2
Mali i Zi	5.3	2.9	3.2	7.2	13.5	21.0	25
Serbia	n.a.	n.a.	n.a.	11.3	15.5	17.8	19
Kosova	2	3.5	3.7	3.5	4.3	5.9	6.0

Burimi: Raportet vjetore të Bankave Qëndrore të vendeve përkatëse

Normat e interesit në Kosovë

Nga tabela 11 vihet re se normat e interesit për kredinë në Euro në Kosovë në fund

të vitit 2011 janë 14.3 për qind. Me kushte të kreditimit shumë të vështira, burimi kryesor i financimit të aktivitetit kreditor në Kosovë janë depozitat e qytetarëve. Kjo tregon se norma e interesit në nivele kaq të larta është një barrë shumë e madhe për bizneset.

Tabela 11 : Normat e interesit për kredi në monedhën vendase dhe në monedhë të huaj, në %

Shtetet	Shqipëria	Kroacia	Serbia	Mali i Zi	Maqedonia	Kosova
Monedha vendase	12,11	9,78	17,91	-	9,63	-
EUR	7,44	6,35	8,36	-	7,65	14,3
USD	7,56	-		-	5,07	-
CHF	-	-	5,22	-	-	-
Të tjera	-	7,45	10,03	9,67	-	-
Mesatarja Totale	7,50	6,90	7,87	9,67	6,36	14,3

Burimi: Raportet vjetore të Bankave Qëndrore të vendeve përkatëse

Nga tabela 11 vihet re se Kosova është ndër vendet me normë mesatare interesi për kredi më të lartë krahasuar me vendet e rajonit. Faktorët të cilët kanë ndikuar në përcaktimin e normave të interesit janë të jashtëm (kryesisht janë të lidhur me rreziqet e shkaktuara nga situata e paqëndrueshme makroekonomike dhe politike), dhe të brendshëm si më poshtë:

- mënyra se si janë manaxhuar kreditë me probleme
- një sistem gjyqësor dhe kadastral me shumë probleme. Pra, të drejtat në lidhje me pronën e cila është forma kryesore e kolateralit, e që në rast të rregullimit të këtij problemi, atëherë oferta për kredi afatgjate do të rritej, të cilat do të ofroheshin me norma më të ulëta interesi.
- niveli i ulët i konkurrencës në sistemin bankar.
- niveli i lartë i informalitetit dhe pasaktësia/manovrimet me pasqyrat financiare të bizneseve.
- pasiguri e lartë në dhënien e kredive dhe rrezik i madh në kthimin e tyre.

Kreditë për ndërmarrjet vazhdojnë të kenë norma të larta interesi në krahasim me kreditë e dhëna për familjarët. Një nga arsyet që mund të ketë ndikuar në caktimin nga ana e bankave të çmimeve më të larta ndaj ndërmarrjeve është ndjeshmëria e tyre ndaj goditjeve në ekonomi, si dhe profili më i lartë i rrezikut të projekteve të biznesit. Në Dhjetor 2011, norma mesatare e interesit për kreditë e ndërmarrjeve ishte 16.4 përqind, ndërkohë që mesatarja për kreditë e individëve ishte 14.1 përqind. Tek kreditë për ndërmarrjet, janë vërejtur se kreditë për qëllime investimi kanë pasur norma të larta interesi.

Normat e interesit, sidomos në kredi, varen shumë nga faktorët që janë nën kontrollin e bankave tregtare si dhe nga faktorë jashtë kontrollit të tyre. Ndikimi i Bankës Qendrore

nëpërmjet instrumenteve të politikës monetare është shumë i kufizuar për shkak të euroizimit të ekonomisë, e cila ka eliminuar instrumentet tradicionale të bankave qendrore për të ndikuar në normat e interesit. Një rritje e efikasitetit të sektorit bankar do të kontribuonte në zvogëlimin e kostove të këtij sektori, duke kontribuar kështu në uljen e normave të kreditimit. Për më tepër, mjedisi në të cilin operon sektori bankar ka një ndikim jashtëzakonisht të rëndësishëm në normat e interesit të kredisë.

Përmirësimi i përgjithshëm i mjedisit të biznesit në vend është një faktor thelbësor për zvogëlimin e rrezikut të kredisë, e cila përfaqëson një nga faktorët kryesorë për përcaktimin e normave të interesit të kredisë. Nga ana tjetër, me rritjen e efikasitetit të sistemit gjyqësor do të lehtësohej ekzekutimi i kolateralit, duke ndikuar kështu në efikasitetin e bankave dhe uljen e rrezikut të kredisë. Gjithashtu, një përmirësim në raportimin financiar nga bizneset do të ketë një ndikim pozitiv në rritjen e besimit të bankave ndaj biznesit, duke ulur kostot e monitorimit. Një tjetër faktor i rëndësishëm për të ulur rrezikun e kredisë është promovimi i qeverisjes korporative në biznese, duke përfshirë edhe një rritje të kapaciteteve të planifikimit, hartimit të planeve objektive dhe të realizueshme të biznesit, etj.

Sfidat për të ardhmen për rajonin - Zgjerimi i kërkesës së brendshme konsumatore në Ballkan, në kushtet kur flukset deri tani të bollshme të fondeve nga bankat mëmë do ulen ndjeshëm për shkak të problemeve të likuiditetit dhe mjaftueshmërisë së kapitalit rregullator që ato vetë po përjetojnë konsiderohet si instrumenti që do të mbajë gjallë ekonominë dhe rritjen ekonomike të një vendi. Kjo për arsye se hapja e bizneseve të reja apo zgjerimi i atyre ekzistuese përmes marrjes së kredive hap vende të reja pune, rrit të ardhurat dhe si rrjedhojë, ndikon në përmirësimin e nivelit të varfërisë. Zgjerimi i kërkesës së brendshme lidhet me dhënien e më shumë kredive nga bankat. Por, nëse normat e interesit nuk ulen, për të ardhmen nuk pritet të ketë zgjerim të kredimarrjes.

Përpjekjet e vazhdueshme për të kapërcyer pengesat/kushtet e pafavorshme (të larta) në normat e interesit kuptojnë në radhë të parë përmirësime në performancën dhe treguesit bazë makroekonomik të vendit, kryesisht me ndikim tek politika e normave te interesit. Kuptohet që këtu në radhë të parë si faktor përcaktues do të renditet raporti kerkesë-ofertë për fonde (në nivel kombëtar raporti kursime/investime). Në afatin e shkurtër apo atë te mesëm ka disa faktorë që duhen identifikuar me veçori për secilin vend dhe mund të ndërmerren disa masa që ndikojnë pozitivisht në normat e interesit, pa kercënuar/prekur parimet bazë të tregut. Kështu mund të renditim disa masa:

Rishqyrtimi i politikës së taksave që ka ndikime negative mbi kursimet. Kosova dhe Shqipëria mund të shohin si politike nxitëse, për pjesëmarrje të gjerë të publikut, për 2-3 vite heqjen e tatimit mbi të ardhurat për investime në letrat me vlerë të qeverisë. Rritja e shkallës së remunerimit të rezervës së detyruar nga Banka Qendrore, në masë të ndryshme sipas veçorive që ka secili vend. Ndoshta ka vend të filloje edhe ulja graduale e nivelit të rezervës së detyruar në të gjitha vendet e rajonit.

Krijimi i politikave, procedurave dhe standardeve të brendshme sa më cilësore në banka, lidhur me miratimin e kredisë, menaxhimin sa më cilësor të portofolit të kredive

Konkluzionet

Literatura e mbledhur nga të gjitha vendet e Evropës Juglindore (EJL) përfshirë edhe Kosovën tregon që niveli i normave të interesit determinohet nga tregu. Në përgjithësi, ky regjion është vlerësuar nga ekspertët të ketë norma (nominale dhe reale) relativisht të larta të interesit në kredi (për individ 14.2% dhe për NVM 16.65% në dhjetor të vitit 2011), të cilat përkthehen në diferencë më të madhe në mes të normës së interesit për kredi dhe normave të interesit për depozita.

Diferenca në mes të normës së interesit për kredi dhe normave të interesit për depozita (që në dhjetor të vitit 2011 ishte 10.8 pike përqindje), është konsideruar si pengesë e madhe për ndërmjetësimin financiar, pasi që me kthimin e vogël në depozita i ka dekurajuar kursyesit potencial, përderisa e ka rritur koston për kredimarrës (posaçërisht individ dhe biznese), dhe kështu i ka zvogëluar mundësitë për investime dhe rritje ekonomike.

Kjo është për tu brengosur, sidomos për ekonomitë në tranzicion, ku mundësitë për burime alternative të financimit përmes tregut kapital janë minimale, ose gati jo ekzistente, si në rastin e Kosovës dhe disa shteteve në regjionin e Evropës Juglindore (EJL), duke i lënë këto vende tërësisht nën fatin e sistemit bankar që është mbizotërues në sistemin financiar. Këto diferenca të larta në Ballkan justifikohen posaçërisht nga mungesa e ekonomisë së shkallës, tregut të kufizuar dhe nivelit relativisht të ulët të konkurrencës në tregun bankar dhe financiar në përgjithësi.

Sektori bankar deri në fund të vitit 2008 në vazhdimësi e ka rritur net profitin (34 milion euro), ky trend është përcjellë nga një rënie në vitin 2009, ku profiti i bankave ka rënë në 27.4 milion euro. Kësaj rënie (24.1%) i atribuohen dy arsye: burokracia e bankave dhe mos ekspozimi ndaj riskut (më së shumti për shkak të krizave me borxhe publike ne Eurozonë) që kanë bërë që të ngriten standardet e dhënies së kredive për NVM. Megjithatë, rezultatet na tregojnë që net profiti i bankave ka pasur një trend të rritjes përsëri në vitin 2010, dhe gjithashtu ka vazhduar në vitin 2011, ku nga fundi i këtij viti sasia e përgjithshme e net profitit në sektorin bankar ishte rreth 37 milion, me një ngritje vjetore prej 13%.

Per më shumë, koncentrimi i lartë i sektorit bankar (i matur me indeksin Herfindahl-Hirschman (HHI)) me 2,175 pikë në tregun e depozitave dhe kredive së bashku, ka pasur një relacion pozitiv me shpërndarjen e normave të interesit (interest rate spreads), ku sa më e lartë është koncentrimi i tregut bankar, më e i lartë është shpërndarja e interesit (interest spread). Hulumtimi jonë ka konstatuar se sistemi bankar në Kosovë mbetet shumë i koncentruar ku tri bankat më të mëdha i mbulojnë 74% të aseteve në sektorin bankar. Kjo do të thotë që bankat në Kosovë vazhdojnë të mbështeten rëndë në strategjinë e shpërndarjes së normës së interesit (interest rate spread), kështu duke i mbajtur artificialisht normat e larta të interesit në kredi.

Për më shumë, ne mund të konkludojmë se është një tendencë rritjeje në depozi-

tat me maturitet më të gjatë, të cilat mund të ndërlidhen me aprovimin e Ligjit mbi Sigurimin e Depozitave, i cili ka një ndikim direkt në rritjen e mëtutjeshme të konfidencës së depozitorëve në bankat komerciale. Gjithashtu, normat e larta të interesit për depozita me maturitet afatgjatë përfaqësojnë një faktor të rëndësishëm që mund të kontribuojë në rritjen e periudhës së maturitetit për depozita afatgjate.

Hulumtimi jonë tregon që indikatorët e performancës si ROA (1.4%) dhe ROE (14.5%), si dhe niveli i kredive të këqija (6 %), e bëjnë sektorin bankar në Kosovë të sigurt dhe më profitabilin krahasuar me vendet e rajonit.

Megjithatë, kur vlerësohet performanca e indikatorëve të kthimit në asete (ROA) dhe kthimi në kapital (ROE) për tri bankat më të mëdha në Kosovë, këta indikator na bëjnë të konkludojmë se një profit edhe më i madh është gjeneruar nga këto banka, ku 90.1% nga net profiti i përgjithshëm në sektorin bankar ka shkuar në tri bankat më të mëdha. Kthimi në asete në fund të vitit 2011 për tri bankat më të mëdha, ka shënuar 1.81% që është më i madh se ROA-ja e sektorit bankar të Kosovës, dhe më e madhe për gjashtë herë se mesatarja e mesatares në regjion. Në anën tjetër, kthimi në kapital (ROE) në vitin 2011 për tri bankat më të mëdha, ka shënuar rritje për 16.33%, e cila është shumë më e lartë se mesatarja e sektorit bankar në Kosovë, dhe katër herë me e madhe se mesatarja e rritjes në rajon.

Sa i përket BQK-së në mënyrë që të kemi norma më të ulëta të interesit në tregun kreditor, ata gjithashtu pajtohen me vlerësimin e bankave komerciale, që një përmirësim i përgjithshëm i ambientit biznesor definitivisht do të nxiste banka të reja të hyjnë në tregun e Kosovës, të cilat do të ishin më konkurruese dhe me efiçiente, duke kontribuar te një kosto më të ulët operacionale dhe si rezultat norma më të ulëta të interesit[12].

Sa i përket rritjes së potencialeve krediduese të bankave, BQK-ja thekson se të gjitha bankat në Kosovë kanë potencial të rritjes së nivelit të kredive në treg, për faktin se likuiditeti i rezervave që mbahen nga bankat në mënyre konsistente i ka tejkaluar kërkesat, në kuptimin që teprica e rezervave potencialisht mund të jepet si kredi në treg. Megjithatë, sipas bankave, ato gjithashtu ballafaqohen me mungesë të projekteve adekuate të cilave mund tu jepen kredi, dhe kjo mund të jetë një arsye pse bankat kanë tepricë të rezervave likuide dhe nuk mund t'i përdorin ato.

Sa i përket Byrosë për Regjistrimin e Kredive e cila është themeluar dhe mbahet nga BQK-ja që nga viti 2006, secila kredi e lëshuar nga bankat komerciale është e regjistruar në këtë Byro. Ky konsiderohet hap i rëndësishëm nga bankat komericale për reduktimin e riskut kreditor për faktin se bankat e kanë mundëisnë t'i marrin informatat më të fundit nga kjo Byro. Bazuar në BQK dhe në bankat komericale, para aprovimit të kredive, secila bankë si dhe institucionet e tjera mikrofinanciare, e konsultojnë Byronë për Regjistrimin e Kredive, që të shikojnë nëse personi që po aplikon për kredi ka marrë tashmë ndonjë kredi tjetër në ndonjë bankë tjetër. Kjo është e dobishme pasi që e elaboron historinë dhe përpikërinë e klientit dhe kështu kontribuon në zvogëlimin e riskut të përgjithshëm për kreditë e dhëna.

Sa i përket letrave me vlerë, bankat komerciale mendojnë se këto mund të kenë një

12 Si përshembull, permiresimi i efikasitetit te sistemit gjyqesor, ulja e eknomise informale, regjistrimi i ndertesave, apartmenteve, shtepive dhe parcelave ne Agjencionin Kadastral

ndikim indirekt në norma të interesit. Për rezervat e bankave prej të cilave nuk fitohet asgjë, BQK-ja dhe banka mendojnë kjo tepricë (duke mos e përfshirë kërkesën e obligueshme me ligj prej 10% për depozita) e fondeve rezervë në bankat komerciale mund të përdoret për investime në letrat me vlerë të qeverisë që sigurojnë normë më të lartë të kthimit (normat e interesit për janar për letrat me vlerë të qeverisë është 3.51%). Kjo do të kontribuojë në uljen e kostos financiare për banka, dhe kjo si rezultat mund t'i ulte normat e interesit.

Duke u bazuar në banka dhe në BQK, një rritje e nivelit të aftësive për përpilimin e planeve të biznesit do të kishte ndikim në norma të interesit. Sa më të mëdha të jenë njohuritë në përpilimin e planeve të biznesit, aq më të mëdha do të jenë mundësitë që këto kompani të kenë dokumentacionin e tyre në rregull (që përfshinë regjistrimin e punëtorëve në ATK, pasqyrat financiare të auditurara, pagesat e rregullta të taksave etj.), dhe të kenë ide të qartë për rrjedhën e biznesit të tyre. Kjo si rezultat do t'u mundësojë bankave që të shikojnë se a po zhvillohet kompania në pajtueshmëri me planin e biznesit dhe kjo pastaj reflektohet në kosto operacionale dhe norma më të ulëta.

Mungesa e konkurrencës në tregun financiar dhe ambienti biznesor joadekuat me konsensus të përgjithshëm vlerësohen si barrierat kryesore për normat e larta të interesit; por përveç kësaj, edhe firmat e mbajnë një pjesë të përgjegjësisë. Evazioni fiskal dhe informaliteti iu pamundësojnë atyre të japin pasqyra financiare bindëse. Për më shumë, mos parashikueshmëria e performancës së firmave kontribuon në riskun e lartë kreditor i cili rezulton me burokracinë e bankave (më pak qasje në financa). Barrierat kyresore në biznes janë institucionale. Të shtyera nga konkurrenca jo fer, korrupsioni, kostoja dhe qasja në financa, krimi i rrugëve (krimi i organizuar) dhe jo stabiliteti politik, këto barriera i rrezikojnë mundësitë për ambient të mirëfilltë biznesor në Kosovë.

Referencat

Rishikim i BSCEE 2010, www.bscee.org

BQK Raporti vjetor 2010. Prishtinë: Banka Qendrore e Kosovës.

BQK Raporti vjetor 2019. Prishtinë: Banka Qendrore e Kosovës.

BQK, 2011. Raporti i Stabilitetit Financiar. Banka Qendrore e Repulikës Kosovës. Prishtinë.

Raporti i Stabilitetit Financiar, 2009, 2010 – Shqipëria

Raporti i Stabilitetit Financiar, 2009, 2010 – Bosnja dhe Hercegovina

Raporti i Stabilitetit Financiar, 2009, 2010 – Kroacia

Raporti i Stabilitetit Financiar, 2009, 2010 – Maqedonia

Raporti i Stabilitetit Financiar, 2009, 2010 – Mali i Zi

Raporti i Stabilitetit Financiar, 2009, 2010 – Serbia

Fondi Monetar Ndërkombëtar. 2011. Republika e Kosovës: Pasqyra konkluduese e vitit 2011 Artikulli IV misioni konsultues. Korrik 2011.

Bankat Komerciale të Kosovës-Raporti Vjetor 2011

Bankat Komerciale të Kosovës-Bilanci i Gjendjes, Dhjetor 2011

Bankat Komerciale të Kosovës-Intervistat 2011

Riinvest. 2001. Studim mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme 2001. USAID.

Riinvest. 2002. Studim mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme 2012. USAID.

Riinvest. 2004. Studim mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme 2004. USAID.

Riinvest. 2006. Studim mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme 2007. USAID.

Riinvest. 2008a. Studim mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme 2009. Instituti Riinvest.

Riinvest. 2008b. Diaspora dhe politikat e migracionit, Prishtinë. Instituti Riinvest

Riinvest. 2010. Strategjia e industiresë në Kosovë. Prishtinë: Instituti Riinvest.

Riinvest. 2011. Zhvillimi i sektorit privat. Prishtinë: Riinvest dhe FES.

EBRD Raporti i tranzicionit (2009) – "Rimëkëmbjes dhe Reformës"

Valentin Toçi (2009) – "Efikasiteti i bankave në Evropën Juglindore: me referencë të veçantë në Kosovë"

Shtojca 1

Normat e interesit në Maqedoni

Në fund të vitit 2010, sistemi bankar Maqedonas përbëhej nga 18 banka, 14 prej tyre zotëroheshin nga aksionarë të huaj, nga të cilat 9 ishin degë të bankave të huaja. Pra, është e qartë që sistemi bankar mbizotërohet nga banka të huaja, por niveli i ndërmjetësimit financiar mbetet në nivele mjaft të ulëta në krahasim me vendet e Bashkimit Evropian. Normat e interesit për kreditë, si për monedhën vendase ashtu edhe për atë të huaj, si edhe për bizneset dhe individët, kanë pasur prirje rënëse që prej vitit 2009. Kjo rënie është mbështetur nga rënia e normave bazë të interesit, nga 9% në vitin 2009 në 4% në 2011. Kredia për këtë periudhë ka marrë shtysë nga rritja e depozitave, veçanërisht nga individët si faktor kryesor, duke shprehur kështu edhe një rritje të besimit të publikut në sektorin bankar.

Shtojca 2

Normat e interesit në Serbi

Pavarësisht faktit se sektori bankar në Serbi konsiderohet si pjesa më e suksesshme e ekonomisë, normat e interesit për kredi të vendosura nga bankat serbe janë në nivele tepër të larta. Si shkak për këtë mbeten niveli i lartë i inflacionit dhe politika e ndjekur nga Banka Qendrore. Pra, banka në mënyrë që të mbajë normën e inflacionit në nivelin e dëshiruar aplikon norma të larta interesi. Nga ana tjetër, normat e interesit për depozitat janë shumë më të larta se vendet e rajonit (me përjashtim të Kosovës) dhe si rrjedhojë bizneset e këtyre vendeve zgjedhin bankat serbe për të vendosur kursimet e tyre. Mbajtja e normës së interesit në nivele të larta ka rritur vështirësitë e kredimarrësve në vitet e fundit për të shlyer kreditë e përfituara, duke ndikuar në rritjen e nivelit të kredive me probleme në masën 9.2% për individët dhe 20% për korporatat në fund të vitit 2010.

Shtojca 3

Normat e interesit në Shqipëri

Për shkak të numrit të bankave, konkurrenca e tregut dhe kushtet e shërbimeve bankare kanë përjetuar një përmirësim në Shqipëri. Sidoqoftë, ndërmjetësimi financiar në vend është ende i ulët, gjë që paraqet pengesë për zgjerimin e sektorit privat, i cili përbëhet kryesisht nga ndërmarrjet e vogla dhe te mesme. Pavarësisht një rënie të ulët në raport me periudhat e mëparshme, normat e interesit në Shqipëri konsiderohen relativisht të larta, sepse norma bazë e interesit e përcaktuar nga Banka Qendrore për marrëveshjet e riblerjes është ende e lartë (5.00%), krahasuar me normat bazë të ri-financimit të aplikuara nga Banka Qendrore Evropiane (1.25%) apo Rezerva Federale (0.25%). Këto norma aplikohen për të siguruar një stabilitet çmimesh në vend, pra për të ruajtur inflacionin brenda niveleve të caktuara. Sidoqoftë, këto norma

kanë ndikimin e tyre në normat e interesit të kredive në monedhën vendase.

Në analizën e normave të interesit për kredi në vend, mund të thuhet që një nga arsyet për normat disi më të larta të interesit të kredive në raport me rajonin, është norma vjetore e kthimit të investimeve mbi Bonot e Thesarit (të borxhit të qeverisë), e cila paraqitet disi më e lartë në raport me pjesën tjetër të vendeve Evropiane. Kjo normë ka mjaft rëndësi, pasi shumica e bankave në vend e përcaktojnë normën e interesit për kreditë konsumatore duke marrë si tregues referencë normën vjetore të Bonove të Thesarit, duke bërë që normat e interesit të kredive të luhaten sipas lëvizjeve të normave të interesit.

Po kështu niveli i rezervës së detyrueshme dhe norma e remunerimit të saj kanë ndikuar në nivelin e normave të interesit në treg. Bankat tregtare në Shqipëri shfaqin të njëjtën prirje me bankat e rajonit për të plotësuar "humbjen" nga angazhimi i fondeve të tyre në rezervën e detyrueshme, e kërkuar në formë të detyrueshme nga Banka Qendrore (e cila remunerohet me interesa të ulëta), duke bërë që marzhi të lëvizë pas disa periudhash në rast të ndryshimit të nivelit të rezervës.

Në caktimin e normës së interesit përfshihet edhe një shtesë në formën e një primi rreziku. Pra, mënyra se si ndërtohen normat e interesit të kredive është e tillë: kosto e fondeve (për çdo monedhë) plus primi i riskut për çdo segment (individ, ndërmarrjet e vogla dhe te mesme dhe korporatë) plus marzhin e fitimit individual të bankës përkatëse. Tek primi i rrezikut për çdo segment janë gjithnjë të inkorporuar rreziqe të ndryshme, siç është ai i vendit, degës, sektorit, i klientit, likuiditetit, maturitetit etj. Për një kohë të gjatë për bankat në Shqipëri, primi minimal i riskut ka qenë 3% (pra, 3 lekë të humbura për çdo 100 lekë).

Mbi këtë logjikë, normat e interesit për monedhën vendase janë përgjithësisht më të larta, ndërkohë që në valutë paraqiten të zbutura, meqenëse për këto norma ndiqet prirja e indekseve të normave ndërkombëtare (Euribor, Libor ose norma bazë e Rezervës Federale apo e Bankës Qendrore Evropiane).

Një tjetër çështje që ndikon në normat e interesit për kredi të ofruara nga bankat, veçanërisht për bizneset, janë edhe problemet me regjistrimin e kolateralit dhe ekzekutimin e tij në rast nevoje, probleme të cilat duhet të merren në konsideratë kur vlerësojmë normat e përcaktuara në tregun shqiptar të kredisë.

Në Shqipëri është vënë re gjatë tre viteve të fundit një rritje në shpenzimet e provigjionimit për shkak të rritjes së aktiveve që mbartin rrezik, duke bërë që marzhi neto i normës së interesit të rritet. Ky nivel ne fund të tremujorit të tretë të vitit 2011 sipas Bankës së Shqipërisë arriti në nivelin e 18%.

Të ardhurat nga jo-interesat (pra, nga komisionet etj) në Shqipëri provojnë që në rastet kur ato janë të larta, pas një periudhe të caktuar kohore, ato çojnë në një rënie të interesave për kredi, duke shërbyer si zëvendësues/kompenzues të njëri-tjetrit.

Gjithashtu, edhe pse bankat kanë qenë duke shtuar kapital, si rezultat i kërkesave nga autoriteti mbikëqyrës, ato kanë qenë më të kujdesshme në drejtim të kredisë dhe të normave përkatëse të interesit, duke qenë se sa më i lartë kapitali i angazhuar, aq

më i lartë është edhe rreziku i marrë përsipër. Nga ana tjetër, ndryshimet politike dhe ekonomike të cilat kanë ndodhur në Shqipëri kanë ndikuar zhvillimin e sistemit bankar, i cili ka kaluar në një sistem dy-nivelor, ka njohur një proces privatizimi, liberalizim të kreditimit, instrumente indirektë të politikës monetare, konsolidim të kuadrit rregullator dhe mbikëqyrës, hapje ndaj institucioneve financiare të huaja, si edhe procese bashkimi apo shkrirje të bankave. Të gjithë këta faktorë kanë ndikuar në produktet, shërbimet, si edhe normat e interesit të cilat i ofrohen publikut.

Në përfundim, marzhi neto i normës së interesit në Shqipëri është ndikuar pozitivisht nga luhatshmëria e normës së interesit (Euribor, norma bazë e monedhës vendase, dhe disi nga Libor), nga niveli i shpenzimeve operative të bankave, të cilat kanë pasur një prirje rritëse, si edhe nga shuma e rezervës së bankave të vendosura pranë Bankës Qendrore. Faktorë të tjerë përcaktues janë niveli i kapitalizimit të bankave, të ardhurat neto nga komisionet, efektiviteti i menaxhimit, rreziku i kredisë dhe niveli i përqendrimit në terma të kreditimit.